

Florentina Dedushaj

Ganimete Jashari

Libër për mësuesin

Njeriu dhe natyra

5




Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: <https://www.botimepegi.al/>

Libër për mësuesin

Njeriu dhe natyra

5



BOTIME

pegi

Florentina Dedushaj

Ganimete Jashari

LIBËR PËR MËSUESIN NJERIU DHE NATYRA 5

Për klasën e 5-të të arsimit fillor

BOTIME



Prishtinë, 2022



Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e pestë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. xxx, të datës xxx.

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTi-t: Lulzim Millaku, Dashurie Shaqiri,
Shemsi Morina
Korrektor: Beniamin SHURDHI
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-60-7

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, gusht 2022
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

I/e nderuar mësimehdhënes/e,

Teksti “Njeriu dhe natyra” për klasën e pestë është dizajnuar sipas katër koncepteve që i përfshin kjo fushë-lëndë (Njeriu dhe natyra). Ky libër përmban bazën e njohjes dhe të të kuptuarit e botës përmes këtyre katër koncepteve. Shkenca u mëson nxënësve të mendojnë në mënyrë të strukturuar, gjë që ndihmon për të analizuar dhe zgjidhur problemet.

Lënda “Njeriu dhe natyra” kontribuon po ashtu në zhvillimin e kompetencave, të cilat i ndihmojnë nxënësit në jetën e përditshme.

Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës “Njeriu dhe natyra”, mësimehdhënesi/ ja duhet të përzgjedhë metodologjitë më adekuate, si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke i përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve.

Në bazë të përmbajtjes së temave, mësimehdhënesi/ja përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme me qëllim të realizimit të aktiviteteve në mënyrë praktike. Përdorimi i elementeve të praktikës si dhe prezantimi nga ana e nxënësve para të tjerëve kontribuon që të arrihen në tërësi rezultatet (RNF dhe RNL) si dhe kompetencat sipas K.B.

Të nxënit efektiv kërkon zhvillimin e aftësive, të sjelljeve dhe të motivimit. Kjo mund të arrihet përmes mësimehdhënes efektiv dhe përdorimit të aktiviteteve të thjeshta, ku nxënësve iu japin mundësi të vendosin qëllimin e tyre personal, përkrah qëllimit të vendosur nga mësuesi/ja për përvetësimin e njësive të caktuar\konceptit të caktuar shkencor.

Libri i mësuesit shërben si udhëzues për mësimehdhënesit gjatë planifikimit të njësive mësimore

Ky libër përmban një laramani mënyrash të të nxënit dhe të mësimehdhënes, si lexime dhe shkrime individuale, diskutim pune në grupe dhe çifte, veprimtari dhe diskutime të të gjithë klasës, hulumtim shkencor, zgjidhje të problemeve, prezantime etj.

Mësimehdhënesi/ja zbaton forma ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore dhe krijuese gjatë mësimehdhënes dhe mësimehdhënes.

Këtu keni të paraqitura disa nga teknikat, të cilat mund të përdoren në faza të ndryshme të orës që kontribuojnë në arritjen e rezultateve (RNL dhe RNF).

Ju urojmë punë të mbarë!

		SHKOLLA:		2022-2023	
		PLANI VJETOR:		SHKENCAT E NATYRËS	
		FUSHA E KURRIKULËS:		V	
		KLASA :			
Lënda-ët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDAR A GJATË MUAJVE			Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës 2 (Klasa e V-të).	
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	I
	SHTATOR-TETOR (16)	NËNTOR-DHJETOR (16)	JANAR-SHKURT-MARS (22)	PRILL – MAJ- QERSHOR (20)	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
	Lënda dhe vetitë e saj	Qeliza	Matja e madhësive themelore në fizikë	Puna, energjia dhe përhapja e dritës	1, 2, 3, 8
	Burimet natyrore dhe rëndësia e tyre	Puberteti dhe Përshtatja	Puna, energjia dhe përhapja e dritës	Vendi dhe hapësira	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ
		Mjediset jetësore		Sistemet fizike	1, 2, 4, 6, 7, 8
Lënda: Njeriu dhe natyra					Kompetenca e të nxënimit – Nxënës i suksesshëm
					1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, 9
					Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
					2, 3, 4,
					Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
					8, 9
					Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
					2, 5,

PLANI DYMJOR: VITI SHKOLLOR: FUSHA E KURRIKULËS: LËNDA: KLASA:		SHKENCAT E NATYRËS NJERIU DHE NATYRA V
TEMA-T mësimore:	- Lënda dhe vetitë e saj; Burimet natyrore dhe rëndësia e tyre; Qeliza; Pubërteti dhe Përshtatja; Mjediset jetësore; Matja e madhësive themelore në fizikë; Puna, energjia dhe përhapja e dritës; Vendi dhe hapsira; Sistemet fizike	
RNK- Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:		
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv		
I.1 Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.		
I.2 Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.		
I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërrhyje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.		
I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.		
Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ		
II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.		
II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësues, gazete, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).		
II.4 Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.		
II.6 Përshkruan dukuritë e caktuara (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.		
II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash;		
II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.		
Kompetenca e të nxënësve – Nxënës i suksesshëm		
III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.		
III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.		
III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).		
III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;		
III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.		

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët. III.8 Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj. III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informata/njohuri për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv IV.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre. IV.3 Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e prekupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.. IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj). V.9 Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtrashme të punës (ajrosje, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.). Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët. RNF- Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shijellimit të temës/ve:	
1.1 Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërtimeve të tyre.	

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënimit për temën mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gjuhët ndërkulturore	Burimet
Lënda dhe vetitë e saj	Tregon se lëndët janë të ndëruara nga grimca shumë të vogla. Shpjegon gjendjet agregate të lëndëve në nivel grimcor. Dallon ndryshimet fizike nga ndryshimet kimike dhe demonstroi shembuj të thjeshtë të këtyre ndryshimeve që i hasim në jetën e përditshme.	1. Hyrje në lëndën “Njeriu dhe natyra 5” (P) 2. Ndryshimi i gjendjes së lëndës f. 6 (ZH) 3. Ndryshimet fizike dhe kimike të lëndës f. 8 (ZH) 4. Përdorimi i lëndës në jetën e përditshme f. 10 (ZH) 5. Përf forcimi i njësive të mësuara (P) 6. Metalet dhe vetitë e tyre f. 12 (ZH) 7. Mineralët në vendin tonë f. 13 (ZH) 8. Hekuri dhe alumini, përdorimi i tyre në jetën e përditshme f. 16 (ZH) 9. Përdorimi i gurit gëlqeror f. 18 (ZH) 10. Përf forcimi i njësive të mësuara (P) 11. Lëndët djegëse fosile, qymyri, nafta dhe gazi natyror f. 20 (ZH) 12. Ndotja e mjedisit f. 22 (ZH) 13. Si mund të zvogëlohet ndotja e mjedisit f. 24 (ZH) 14. Ndotja e tokës f. 26 (ZH) 15. Përf forcimi i njësive të mësuara (P)		Mësimdhënja dhe të nxënimit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje Mësimdhënja dhe të nxënimit e bazuar në arrijen e kompetencave Mësimdhënja dhe të nxënimit e integruar Mësimdhënja dhe të nxënimit e diferencuar	Vlerësim i vazhdueshëm VpN Vlerësim motivues Lista e kontrollit Informata kthyes Vlerësimi i ndërsjellë Portofol Detyra shtëpie Diskutime	Gjuhë amtare Matematikë Edukatë figurative Jeta dhe puna Shoqëria dhe mjedisi Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Njeriu dhe natyra 5 Njeriu dhe natyra FP 5 Burime interneti

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gëshjet ndërkulturore	Burimet
Qeliza	Përshkruan rëndësinë e disa mineraleve (guri gëlqeror, mermeri, rëra, argjila, etj.) në jetën tonë. Dallon lëndët e djegshme fosile sipas gjendjes agregate. Shpjegon formimin e lëndëve fosile dhe rolin e tyre si burim i energjisë dhe si lëndë e parë në industri. Shpjegon ndotjen e mjedisit nga djegia e lëndëve fosile dhe jep ide se si mund të zvogëlohet kjo ndotje.	16. Kontrolloni përparimin tuaj 17. Qeliza dhe zbulimi i saj f. 28 (ZH) 18. Organizmat dhe larmia e qelizave të tyre f. 30 (ZH) 19. Çfarë ka brenda qelizës shtazore f. 32 (ZH) 20. Çfarë ka brenda qelizës bimore f. 34 (ZH) 21. Përf forcim i njësive të mësuara (P) 22. Ndërtimi i një organizmi/ Nga qeliza tek organizmi f. 36 (ZH) 23. Riprodhimi i qelizave f. 38 (ZH) 24. Punë praktike. Vëzhgimi i qelizës bimore dhe shtazore me mikroskop f. 40 (P) 25. Puberteti f. 42 (ZH) 26. Ndikimi i pubertetit në marrdheniet me të tjerët f. 44 (ZH) 27. Si të ruheni nga abuzimet f. 46 (ZH) 28. Përf forcim i njësive të mësuara (P)					
	Shpjegon si, kur dhe nga kush u zbulua qeliza për herë të parë. Shpjegon konceptin për qelizën si term i përdorur për herë të parë të nxënësit dhe hierarkinë e ndërtimit të qenieve të gjalla (qeliza-in-di-organi-sistemi i organeve-organizmi).						

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gjuhët ndërkulturore	Burimet
Puberteti dhe Përshtatja	Identifikon pjesët kryesore ndërtuese të qelizës (membranën, murin qelizor, bërthamën dhe citoplazmën). Shpjegon konceptin, organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizor.	29. Njeriu dhe shëndeti f. 48 (ZH) 30. Ndikimi i ushqimit në shëndetin e njeriut f. 50 (ZH) 31. Substancat psikoaktive, efekti i substancave të dëmshme f. 52 (ZH) 32. Kontrolloni përparimin tuaj					
	Përkrahet format dhe madhësitë e qelizave. Krahason ndërtimin e qelizës bimë dhe shtazore. Përkrahet aftësinë e shumimit të qelizave. Demonstron punën me mjete zmadhuese (Lupë-thjerrëz, mikroskop).	33. Madhësitë fizike dhe matja e tyre f. 54 (ZH) 34. Gjatësia dhe matja e saj f. 56 (ZH) 35. Vëllimi dhe matja e tij f. 58 (ZH) 36. Përfundim i njësive të mësuarara (P) 37. Masa dhe matja e saj f. 60 (ZH)					
Mjediset jetësore	Shpjegon se vlerat dhe besimet nga familja dhe komuniteti janë udhëheqëse për kuptimin gjinor dhe seksualitetin. Përkrahet ndryshimet që ndodhin në pubertet.	38. Koha dhe matja e saj f. 62 (ZH) 39. Temperatura dhe matja e saj f. 64 (ZH) 40. Përfundim i njësive të mësuarara (P) 41. Puna fizike. Fuqia f. 66 (ZH) 42. Puna dhe energjia mekanike f. 68 (ZH)					

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gjuhët ndërkulturo-lare	Burimet
Matja e madhësive themelore në fizikë	Dallon ndryshimet mes të shoqërisë, shoqërorizimit, relacioneve dhe takimeve. Identifikon situatat e abuzimeve seksuale, mënyrat e shmangies dhe di ku të kërkoj ndihmë.	43. Energjia diellore dhe përdorimi i saj f. 70 (ZH) 44. Energjitë e ripërtëritshme dhe hidrike f. 72 (ZH) 45. Të tjera energji të ripërtëritshme f.74 (ZH) 46. Përf forcim i njëj sive të mës uara (P) 47. N xhtësia dhe transferimi i saj f. 76 (ZH) 48. Moti dhe matjet për të f. 78 (ZH) 49. Era, retë dhe reshjet në Tokë f. 80 (ZH) 50. Përf forcim i njëj sive të mës uara (P) 51. Elek triciteti f. 82 (ZH) 52. Rryma elektrike dhe burimet e saj f. 84 (ZH) 53. Qarku elektrik f.86 (ZH) 54. Punë praktike. Qarku elektrik f.88 (P) 55. Kontrolloni përparimin tuaj 56. Drita, burimet dhe karakteris-tikat e saj f. 90 (ZH) 57. Pasqyrimi dhe përthyerja e dritës f. 92 (ZH)					
Puna, energjia dhe përhapja e dritës	Shpjegon faktorët mjedisor që ndikojnë në shëndetin e njeriut përgjatë fazave të zhvillimit individual (ushqimi, marrëdhëniet sociale, substancat psiko-aktive). Përkufizon gjatësinë, paraqet njësinë matëse të saj, lidhjen mes nënfishave dhe shumëfishave dhe shembuj të matjes nga jeta e përditshme. Demonstron përcaktimin e masës së trupit me peshore dykra hëshe, njësinë matëse dhe lidhjen mes dërhemëve më të vegjël të saj.						

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gjuhët ndërkulturore	Burimet
	Demonstron përcaktimin e njësisë matëse të lëngjeve me ndihmën e vëllimit të kubit me brinjë 1dm. Demonstron përcaktimin e vëllimit të trupit të parregullt. Paraqet njësinë e matjes së kohës, njësitë më të mëdha dhe lloje të ndryshme të pajisjeve për matje të saj. Përshkruan parimin e krijimit të shkallës së celsiusit dhe dallon termometrat për matje të temperaturës së njeriut, për bujqësi dhe meteorologji. Dallon me shembuj lloje të ndryshme të punëve në fizikë nga punët mendore. Prezanton shembuj nga jeta e përditshme për lloje të ndryshme të energjive mekanike. Vë në dukje pajisje për shfrytëzimin e energjisë diellore.	58. Drita dhe ngjyrat e saj f. 94 (ZH) 59. Përforsim i njësive të mësuara (P) 60. Sistemi ynë diellor f. 96 (ZH) 61. Dielli, burim i jetës f. 98 (ZH) 62.Përforsim i njësive të mësuara (P) 63. Toka jonë f. 100 (ZH) 64. Punë praktike. Pasojat e rrotullimit të Tokës f. 102 (P) 65. Globi. Harta të ndryshme f. 104 (ZH) 66. Hëna, sateliti natyror i Tokës f. 106 (ZH) 67. Toka ndryshon f. 108 (ZH) 68.Përforsim i njësive të mësuara (P) 69. Lëvizja e ujit të deteve dhe oqeanëve f. 110 (ZH) 70. Atmosfera dhe elementet meteorologjike f. 112 (ZH) 71. Uji dhe rëndësia e tij për jetën f. 114 (ZH) 72.Përforsim i njësive të mësuara (P) 73. Kontrolloni përparimin tuaj 74. Vlerësim i nxënësve					

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gëshjet ndërkurrikulare	Burimet
Vendi dhe hapësira	Shpjegon shfrytëzimin e energjisë së ujit, erës, të biomasës dhe ujërave termal. Paraqet shembuj të mënyrave të bartjes së energjisë në natyrë. Demonstron me shembuj kalimin e nxehtësisë nga lënda e nxehtë në lëndën e ftohtë dhe arritjen e baraspeshimit termik. Shpjegon disa nga aktivitetet që kryhen në stacionin meteorologjik.						
Sistemet fizike	Shpjegon katër llojet themelore të reve dhe përshkruan mënyrën e krijimit të reshjeve në tokë dhe në atmosferë. Vë në dukje lloje të burimeve të rrymës elektrike. Demonstron qarkun e përbërë elektrik me dy-tre shpenzues të lidhur sipas dy mënyrave të mundshme.						

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gëshjet ndërkurrikulare	Burimet
Bashkëveprimi njeri-natyrë	Demonstron reflektimin e dritës në pasqyrë të rrafshët dhe shpjegon karakteristikat e shëmbël-limit në to. Demonstron thyerjen e dritës gjatë kalimit nëpër dy mjedise me dendësi të ndryshme. Demonstron thyerjen e dritës nëpër prizëm, krijimin e ngjyrave nga drita rënës e bardhë dhe krijimin e mirazheve. Përshkruan gjithësinë dhe sistemin diellor, yjet, planetët, asteroidet, kometat, satelitët dhe hënën si trup qiellor e satelit natyror i Tokës. Përshkruan Diellin si burim i jetës, pjerësinë e rrezeve të Diellit dhe krijimin e zonave natyrore (brezat klimatik). Përshkruan formën e Tokës me dëshmi, duke e krahasuar me globin.						

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gëshhyet ndërkurrikulare	Burimet
	Shpjegon rrotullimet e Tokës rreth Diellit dhe rreth boshtit të saj, si dhe rrjedhojat e këtyre lëvizjeve. Identifikon dhe demonstroi mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre. Dallon sferat e brendshme të Tokës dhe përshkruan koren e Tokës-litosferën, e cila përbëhet nga shkëmbinj dhe lloje të ndryshme të tokave, me forma të ndryshme relievore-relievi-rrethina, me veçoritë e saj: malet, fushat, luginat, grykat, kanionet, ujëvarat. Dallon dhe shpjegon vetitë themelore të atmosferës dhe elementeve meteorologjike si: temperatura e ajrit, shtrypja e ajrit, lëvizja e ajrit-era, lagështia e ajrit-resnjë, llojet e reve. Përshkruan prezencën dhe rëndësinë e ujit në Tokë, lëvizjet e ujit të detit, formimin e ujërave nëntokësore-minerale e sipër						

Tema-t mësimore		Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me gjuhëjet ndërkulturore	Burimet
		faqësore dhe qarkullimin e ujit në natyrë. Dallon disa nga llojet e ndorjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndorjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave-ndërtimet në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj						

1.1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës : • Tregon se lëndët janë të ndërtuara nga grimca shumë të vogla. • Shpjegon gjendjet agregate të lëndëve në nivel grimcor.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.1, III.4	
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1 Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: <i>Ndryshimi i gjendjes së lëndës</i>	
Fjalët kyçe: <i>i ngurtë, i lëngët, i gaztë</i>	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: • Tregon nga se janë ndërtuar lëndët • Identifikon gjendjet agregate të lëndëve • Argumenton lëvizjen e grimcave	
Kriteret e suksesit: • Trego nga se janë lëndët që na rrethojnë në klasë • Përshkruajë gjendjen agregate të lëndëve si uji, druri, tymi • Argumento përmes aktivitetit lëvizjen e grimcave të ngurta, të lëngta, të gazta	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Libri i nxënësit, burime nga interneti</i>	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm, Edukimi për media</i>	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Fillimisht para nxënësve shfaqen përmes projektorit fotografitë e gurit, drurit, ujit dhe tullumbacës së fryer.	
   	

Pastaj nxësëve u parashtrohet pyetja:


Çfarë dallimesh kanë mes tyre guri, druri, uji dhe tullumbacia e fryer?

Marrim dy-tri përgjigje nga nxënësit, paraqitet njësia mësimore “Ndryshimi i gjendjes së lëndës” Ipen shpjegimet për materien dhe vetitë e saj, udhëzohen nxënësit t’i hapin librat e tyre f. 6 dhe të lexojnë.

Pasi të lexohet mësuesi/ja nxit nxënësit me pyetje për të marrë informacione rreth lëndës, si:

- Nga çfarë përbëhen gjërat?
- Cilat janë vetitë e materies?
- Në sa forma mund ta gjejmë materien?
- Si mund t’i grupojmë lëndët për nga gjendja e materies?

Me përgjigjet e marr nga nxënësit mësuesi/ja formon një Grafik organizues në tabelë.



Ipen informacione tjera për lëndët dhe dallimin e tyre mes vete për nga forma, vëllimi, ngjeshja. Përmes pyetjeve të parashtruara për nxënësit dhe përgjigjeve të marra nga ta, mësuesi/ja shkruan në tabelë.

“Lënda përbëhet nga grimca shumë të vogla që quhen molekulaose atome. Ato nuk mund të shihen me sy të lirë, por vetëm me mjete zmadhuese speciale.”

Trupa e ngurtë —————> e ruajnë formën dhe vëllimin e tyre

Trupat e lëngët —————> nuk kanë formë të caktuar, por kanë vëllim të caktuar

Trupat e gaztë —————> nuk kanë as formë, as vëllim të caktuar

Para nxënësve shfaqet videoja përmes projektorit për grimcat dhe lëvizjet e tyre varësisht nga gjendja agregate.

<https://www.youtube.com/watch?v=bwGim-eceS8&t=73s>

Në fund zhvillohet aktiviteti me nxënës, ku ftohen 5 apo 6 nxënës të dalin te tabela, ju shpjegohen rregullat se si duhet grupuar varësisht nga urdhëri që marrin për të imituar një trup të ngurtë, të lëngët apo të gaztë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm dhe komenteve konstruktive

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ipet rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës/ Lënda:Njeriu dhe natyra Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Dallon ndryshimet fizike nga ndryshimet kimike dhe demonstroi shembuj të thjeshtë të këtyre ndryshimeve që i hasim në jetën e përditshme.</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.6, II.8, III.4	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Ndryshimet fizike dhe kimike të lëndës	
Fjalët kyçe: <i>ndryshim fizik, ndryshim kimik</i>	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:	
• Dallon ndryshimet fizike nga ato kimike • Argumenton ndryshimet fizike dhe kimike • Krahason ndryshimet fizike dhe kimike	
Kriteret e suksesit:	
• Dallo ndryshimet fizike nga ato kimike në dy-tre lëndë të ndryshme • Argumento ndryshimet fizike dhe kimike bazuar në shembuj • Përkruaj ndryshimet fizike dhe kimike të lëndëve që ndodhin në natyrë	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, burime nga interneti, mollë, patate	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja, përmes projektorit prezanton fotografitë e drurit të prerë dhe atij të djegur.	
	
Pyetën nxënësit: <i>Çfarë ndryshimi pëson lënda gjatë prerjes së drurit në copëza të vogla ? Djegia e drurit është ndryshim kimik apo fizik?</i> Merren përgjigje nga nxënësit, vazhdohet me pyetjen,	

Si mund të dallojmë nëse ka ndodhur një ndryshim kimik apo fizik i lëndës?

Për të sqaruar më mire këtë do ta shohim në vazhdim në videon e paraqitur përmes projektorit.

https://www.youtube.com/watch?v=6QTLiUk_jwg&t=241s

Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat f. 8 dhe të lexojnë tekstin “Ndryshimet fizike dhe kimike të lëndës”.

Pasi ta kenë lexuar diskutohet rreth ndryshimeve fizike dhe kimike duke ju parashtruar nxënësve pyetje:

Cilat janë ndryshimet fizike?

Si mund t'i vërejmë ndryshimet fizike?

Çfarë ndodh gjatë një ndryshimi kimik?

Cilat janë ndryshimet kimike?

Marrim përgjigje nga nxënësit dhe sipas nevojës përgjigjet jo të plota plotësohen nga mësuesi/ja.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur dhe në libër, ku mësuesi/ja paraprakisht sjellë në klasë një mollë, një patate dhe thikë frutash. Ndiqen hapat e veprimtarisë dhe shohim se si copat e mollës dhe të patatës ndryshojnë ngjyrë nga e bardha në ngjyrë kafe. Tanimë nxënësit kanë parë nga afër ndryshimin kimik, pra, *kalbja e pemëve dhe perimeve është një ndryshim kimik*.

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë të pavarur të plotësojnë rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

Lexohet plotësimi i fjalive nga një apo dy nxënës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Të identifikojnë disa ndryshime të lëndës që ndodhin në natyrë, si dhe të tregojnë nëse këto ndryshime janë fizike apo kimike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore


1.3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon një ndryshim kimik me anë të ngjyrës së përzierjes, lirim të gazrave ose erës</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1, II.8, III.4,	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1, 2.3, 2.5	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Përdorimi i lëndës në jetën e përditshme	
Fjalët kyçe: materialet, metalet, jometale, vetitë e materialeve	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:	
• Identifikon materialet e objekteve • Përshkruan materialet në bazë të vetive të tyre • Krahason materialet në metale dhe jometale	
Kriteret e suksesit:	
• Identifiko materialet e objekteve për rreth tij • Përshkruajë materialet në bazë të vetive të tyre si, ngjyra, forma, fortësia • Krahason materialin e objekteve në klasë	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, letër, laps	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja fton para klasës disa nxënës dhe kërkon të marrin me vete ndonjë send, mjet shkollor apo diçka që gjendet mbi bankë të tyre, emrat e sendeve mësuesi/ja i shkruan në tabelë (si: laps, shishe plastike, shishe xhami, mprehëse, fletore, termos metali), pastaj pyet nxënësit se nga cili material përbëhen këto gjëra . Merren përgjigjet nga nxënësit si: metali, druri, xhami, plastika, analizohen së bashku me nxënës llojet e materialeve duke i krahasuar ato sipas ngjyrës, formës, elasticitetit. Paraqitet njësia e re mësimore, “Përdorimi i lëndës në jetën e përditshme”. Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat f.10 . Analizohet fotoja e paraqitur në libër. Mësuesi/ja parshtron pyetje për nxënësit. <i>Çfarë shihni në foto? Pse janë bashkuar disa materiale?</i>	

Marrim përgjigje nga nxënësit, përgjigjet plotësohen nga mësuesi/ja duke dhënë informata shtesë rreth materialeve dhe vetive të tyre, duke formuar klasterin në tabelë.



Mësuesi/ja lexon dy shembujt e paraqitur në libër rreth ndërtimit të dy kolibeve të qenushëve, bëhet krahasimi i materialeve të tyre, mësuesi/ja shkruan në tabelë.



- Vetitë kimike të metaleve: shkëlqimi, lakueshmëria, përçueshmëria e nxehtësisë dhe përçueshmëria elektrike.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të analizojnë figurat e paraqitura në libër dhe të identifikojnë ato në metale dhe jometale. Identifikimi bëhet duke diskutuar për secilin objekt.

Zhvillohet veprimtaria, *Identifikimi i materialeve nga të cilat përbëhen disa trupa rreth nesh*.

Për të zhvilluar këtë veprimtari nevojiten një letër dhe një laps, ku nxënësit duhet të vëzhgojnë objektet e ndryshme në klasë, të shkruajnë emrat e tyre dhe të gjejnë materialin nga i cili përbëhen. Prezantohen disa nga gjetjet e nxënësve para klasës.

Objektet	Materiali	Metale	Jometale

Punohet edhe rubrika, *Lexo, mendo dhe përgjigju*. Mësuesi/ja paraqet pyetjet për nxënësit.

Cilat janë disa veti të metaleve? Çfarë vetie kanë materialet transparente? Merren përgjigje nga dy-tre nxënësit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm, listë kontrolli

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Për detyrë shtëpie ipet rubrika, Zbato njohuritë

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon vetitë fizike të metaleve dhe i ndërlidhë ato me përdorimin e tyre</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.8,	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Metalet dhe vetitë e tyre	
Fjalët kyçe: metalet, legurat, vetitë magnetike, përcjellshmëri elektrike, ndryshku	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:	
• Identifikon llojet e materialeve • Analizon ndryshimet e metaleve • Diskuton rreth llojeve të materialeve	
Kriteret e suksesit:	
• Identifiko llojet e materialeve të dy-tri objekteve • Analizo ndryshimet e metaleve në kohë • Diskuto rreth materialeve të objekteve si biçikleta, klasa, dhoma	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, një gotë, lugë metalike, plastike, druri	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
Arsimimi për zhvillim e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja parashtrohet pyetjen nxënësve: <i>Cilat materiale duhet të përdoren për të ndërtuar bankat tuaja?</i> Marrim përgjigje nga nxënësit (druri, metali), parashtrohet pyetja tjetër, <i>Po për të ndërtuar një lopatë cilat materiale na duhen?</i> Marrim përgjigje nga nxënësit.	
Vazhdohet me pyetjen: <i>Keni menduar ndonjëherë pse objektet prej metali e humbin shkëlqimin pas një kohe?</i> Nxënësit paraqesin mendimet e tyre. Mësuesi/ja njofton nxënësit që përmes njësisisë së re mësimore do të mësojnë më shumë rreth metaleve dhe vetive të tyre.	

Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat f.12 dhe të lexojnë individualisht mësimin në paragrafë.

Pas përfundimit të çdo paragrafi mësuesi/ja parashtron pyetje.

Kush bënë pjesë në grupin e metaleve?

Cilat janë vetitë fizike të metaleve?

Si e ndryshojnë metalet formën e tyre?

Pasi të marrim përgjigje nga nxënësit, lexohet paragrafi i dytë, parashtrohet pyetja.

Cilat metale kanë përqeshmëri më të mire të rrymës elektrike?

Lexohet paragrafi tre, parashtrohen pyetjet.

Si mund të jenë metalet?

Cilat metale kanë veti magnetike dhe cilat nuk kanë veti magnetike?

Në çfarë gjendje agregate janë metalet?

Cila është pika më e lartë e shkrirjes së shumicës së metaleve?

Po pikën më të lartë të vlimit cili metal e ka?

Lexohet edhe paragrafi i katërt dhe nxënësve u parashtrohen pyetjet.

Si e humbin shkëlqimin metalet?

Si mund ta parandalojmë ndryshkjen e tyre?

Zhvillohet veprimtaria, *Përcjellja e nxehtësisë në trupa të ndryshëm.*

Mësuesi/ja ka sjellë në klasë një gotë e cila do të mbushet me ujë të nxehtë, në të do të vendosen tri lugë: një metalike, një plastike dhe një lugë druri. Pas një kohe qëndrimi në ujë do të vërehet se luga metalike do të nxehet më shumë se dy lugët tjera. Kjo provë na vërteton se metalet e përcjellin më mire nxehtësinë sesa jometalet.

Mësuesi/ja bashkërisht me nxënësit diskuton pyetjet nga rubrika, Lexo, mendo dhe përgjigju.

VLERËSIMI I NXËNËSVE


Vlerësohet pjesëmarrja aktive në dhënien e përgjigjeve për pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ipet rubrika, Zbato njohuritë

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon minierat kryesore që gjenden në vendin tonë dhe mineralet që nxirren në këto miniera</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës :I.3, II.8, VI.2	
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1, 1.5	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Mineralet në vendin tonë	
Fjalët kyçe: minerale, xehërore, miniera	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:	
• Përmend minierat kryesore të vendit • Klasifikon mineralet që nxirren në miniera • Përshkruan definicionet e mineraleve	
Kriteret e suksesit:	
• Përmend së paku tri minierat kryesore të vendit • Liston mineralet e nxjerra nga minierat • Përshkruan së paku tri definecione rreth mineraleve	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, interneti	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja paraqet në tabelë Grafikun organizues me fjalën Toka:	
	
Pyet nxënësit: <i>Cilat janë burimet kryesore të jetesës që i sigurojmë nga toka?</i>	
Marrim përgjigje nga nxënësit dhe ato të saktat i shkruajmë në tabelë siç janë: <i>ushqimi, energjia, banimi, transporti, veshmbathja, metalet, lëndët e djegshme për energji.</i>	

Paraqitet njësia e re mësimore “Mineralet në vendin tonë”, ipen informata shtesë rreth mineraleve duke prezantuar disa lloje të tyre edhe përmes fotografive të shfaqura përmes projektorit.



Diskutohet rreth mineraleve të cilat gjenden në vendin tonë, prezantohen përmes fotografive edhe disa nga minierat kryesore që gjenden në territorin e Kosovës.



Në tabelë mësuesja shkruan emrat e minierave dhe mineralet që nxirren nga këto miniera.

Plumbi, zinku, argjendi, ari nxirren në minierat e

- “Trepça”
- Artanës
- Hajvalisë
- Kishnicës

Guri dekorativ, guri gëlqeror, mermeri i gjelbër gjenden kryesisht në krahinën e Deçanit dhe të Pejës

Në fund mësuesi/ja së bashku me nxënës formojnë një pesëvargësh për mineralet.

_____	Mineralet
_____	Të ngurta, të forta
_____	Nxirren, përpunohen, shkelqejnë
_____	Mineralet gjenden nën tokë dhe në tokë
_____	Xehe

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të plotësojnë rubrikën, Lexo, mendo dhe përgjigju. Lexohen fjalitë e plotësuara nga dy-tre nxënës


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësohen rubrika: Zbato njohuritë


1.6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Tregon rëndësinë dhe vetitë e metaleve më të përdorshme (hekur dhe alumin)</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.1, II.8,	
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1, 1.5, 2.2,	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Hekuri dhe alumini, përdorimi i tyre në jetën e përditshme	
Fjalët kyçe: ndryshkja, shkëlqimi metalik, xehet	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: • Demonstron dallimin mes hekurit dhe aluminit • Identifikon veçoritë e mineraleve • Rioorganizon njohuritë	
Kriteret e suksesit: • Demonstron dallimin mes hekurit dhe aluminit me shembullin konkret • Identifikon veçoritë e mineraleve të hekurit dhe aluminit • Rioorganizon njohuritë e marra për hekurin dhe aluminin	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, gotë, gozhdë, lugë gjelle, ujë	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja fillon orën duke bërë përsëritje nga njësia e kaluar, nxënësve u parashtrohen pyetje për mineralet, llojet e mineraleve, vetitë e tyre. Ndalet tek hekuri dhe alumini, vihet në diskutimi shembulli, <i>nëse vendosim një gozhdë dhe një lugë gjelle në ujë të kripur për disa ditë, do të vërejmë se gozhda do të ndryshojë pamjen e saj për shkak të ndryshkjes, ndërsa luga mbetet e njëjtë, kjo për arsye se gozhdët janë prej hekuri ndërsa luga e gjellës prej aluminit.</i> Realizohet shembulli dhe gota me ujë lihet anash për të parë më pas rezultatin. Udhëzohen nxënësit t'i librat f. 16 dhe të lexojnë në mënyrë individuale, Përfitimi dhe përpunimi i hekurit, pas leximit mësuesja duke nxitur nxënësit me pyetje nxjerr dhe shkruan në tabelë informatat për hekurin duke formuar grafikun organizues.	
 <pre> graph TD H[Hekuri] --> TL[] H --> TR[] H --> BL[] H --> BR[] </pre>	

Udhëzohen nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale edhe pjesën për aluminin, pas leximit mësuesja duke nxitur nxënësit me pyetje nxjerr dhe shkruan në tabelë edhe informatat për aluminin duke formuar grafikun organizues.



Punohet rubrika, *Lexo, mendo dhe përgjigju*, mësuesi/ja pyet nxënësit dhe merr përgjigje nga ta. Mësuesi/ja paraqet në tabelë Diagramin e Venit dhe nxit nxënësit me pyetje për ta plotësuar.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie ipet rubrika: Zbato njohuritë

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V

Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan rëndësinë e disa mineraleve (guri gëlqeror, mermeri, rëra, argjila, etj) në jetën tonë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.8, III.1, III.4

Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1, 1.5, 2.3

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i gurit gëlqeror

Fjalët kyçe: guri gëlqeror, shkumësi, gëlqerja, çimentoja, mermeri, graniti, argjila

Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon materialet e gurit gëlqeror
- Arsyeton përfitimet e gurit gëlqeror
- Përshkruanë fortësinë e mineraleve

Kriteret e suksesit: • Identifiko materialet e gurit gëlqeror si shkumësi, gëlqerja • Arsyeto së paku tri përfitime nga guri gëlqeror • Përshkruajë fortësinë e mineraleve bazuar në shembuj										
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, lloje gurësh, gur gëlqeror, uthull, enë										
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm										
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE										
Mësuesi/ja fillon orën duke iu parashtruar nxënësve pyetjet: <i>Çfarë materiali përdorim për të shkruar në tabelë të zezë?</i> <i>A keni menduar ndonjëherë për materialin që përdoret për lyerjen e mureve të shtëpive?</i> Merren përgjigje nga nxënësit, mësuesi/ja njofton nxënësit që përmes njësisë do të mësojnë më shumë rreth shkumësit dhe gëlqerës. Nxënësit hapin librat f.18. Lexohet nga mësuesi/ja pjesa me ndalesa, ku pas çdo ndalese parashtrihen pyetje për nxënësit.										
<i>Si e shfrytëzojnë bimët gurin gëlqeror?</i> <i>Si është e mundur që sot nëpër male të larta hasim guaska të gjallesave të detit?</i> <i>Si u krijua guri gëlqeror?</i> <i>Cilët janë llojet e gurit gëlqeror?</i> Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Demonstrohet veprimtaria 1, duke bërë identifikimin e gurit gëlqeror nga gurët tjerë (me mjetet e sjella nga mësuesi/ja) , kështu duke vendosur gurët dhe gurin gëlqeror në një enë mbi të cilët do të hedhim uthullë shohim se guri gëlqeror shkumon dhe shushurit sikur vlon. Vazhdohet leximi në ndalesa nga mësuesi/ja edhe i pjesës tjetër të njësisë, prashtrihen pyetje për nxënësit.										
<table><tr><td>Shkumësi ... kthehet në pluhur.</td><td>Si është shkumësi?</td></tr><tr><td>Gëlqerja ... për gëlqerosjen e mureve.</td><td>Si mund të jetë gëlqerja?</td></tr><tr><td>Çimentoja ... ndërtesave për banim, fabrikave etj.</td><td>Si përfitohet çimentoja?</td></tr><tr><td>Mermeri ... monumenteve kulturore.</td><td>Cfarë është mermeri?</td></tr><tr><td>Graniti ... për shkallët etj.</td><td>Si formohet graniti?</td></tr></table> Demonstrohet veprimtaria 2 “Hulumtimi i fortësisë së mermerit dhe granitit”. Ku mësuesi/ja paraprakisht ka sjellë në klasë një copë mermeri dhe një copë graniti. Fërkohen gurët mes vete dhe do të shohim që guri që do të gërvishet është guri i mermerit. Punohet rubrika, <i>Lexo, mendo, përgjigju</i> . Marrim përgjigje nga nxënësit për pyetjet e parashtruara. Në mënyrë të pavarur nxënësit plotësojnë kërkesën e rubrikës, Zbato njohuritë.	Shkumësi ... kthehet në pluhur.	Si është shkumësi?	Gëlqerja ... për gëlqerosjen e mureve.	Si mund të jetë gëlqerja?	Çimentoja ... ndërtesave për banim, fabrikave etj.	Si përfitohet çimentoja?	Mermeri ... monumenteve kulturore.	Cfarë është mermeri?	Graniti ... për shkallët etj.	Si formohet graniti?
Shkumësi ... kthehet në pluhur.	Si është shkumësi?									
Gëlqerja ... për gëlqerosjen e mureve.	Si mund të jetë gëlqerja?									
Çimentoja ... ndërtesave për banim, fabrikave etj.	Si përfitohet çimentoja?									
Mermeri ... monumenteve kulturore.	Cfarë është mermeri?									
Graniti ... për shkallët etj.	Si formohet graniti?									
VLERËSIMI I NXËNËSVE										
Vlerësimi i vazhdueshëm, Listë kontrolli										
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR										
Fletore pune										
REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE										

1.8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë / Lënda: Njeriu dhe natyra / Shkalla e kurrikulës: II / Klasa: V	
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Dallon lëndët e djegshme fosile sipas gjendjes agregate</i> <i>Shpjegon formimin e lëndëve fosile dhe rolin e tyre si burim i energjisë dhe si lëndë e parë në industri</i>
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.1, I.3, II.6,	
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1, 2.4	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Lëndët djegëse fosile, qymyri, nafta dhe gazi natyror	
Fjalët kyçe: karburant, fosil, naftë, benzinë, vajguri, vaj motorësh, gaz natyror, metan	
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:	
• Dallon lëndët djegëse fosile • Kategorizon lëndët djegëse • Përshkruan përdorimin e lëndëve fosile	
Kriteret e suksesit:	
• Dallon lëndët djegëse fosile si, qymyri, nafta, gazi natyror • Kategorizon lëndët djegëse bazuar në veçoritë e tyre • Përshkruan përdorimin e lëndëve fosile në jetën e përditshme	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit,	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
Mësuesi/ja shfaq përmes projektorit (apo fletë të madhe të hamerit) fotografinë e Termocentralit të Kosovës, vazhdon duke pyetur nxënësit. <i>A keni menduar ndonjëherë se si prodhohet rryma elektrike në Kosovë?</i> Pasi merr përgjigjet nga nxënësit ato të e saktat i shkruan në tabelë, megjithatë mësuesi/ja jep sqarime shtesë rreth prodhimit të energjisë.	

Pjesa më e madhe e rrymës elektrike në vendin tonë prodhohet nga lëndët djegëse fosile.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të hapin librat f.20. Lexohet me paragrafë, njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë, mësuesi/ja parshtron pyetje për këtë pjesë.

Si janë formuar fosilet?

Cfarë ndodh me to nëse i harxhojmë? Nxënësit japin përgjigjet e tyre.

Lexohet paragrafi i dytë nga një nxënës tjetër. Parashtrihen pyetjet për këtë pjesë.

Si është krijuar qymyri?

Ku gjenden vendburimet e qymyrit në Kosovë?

Lexohet paragrafi i tretë nga nxënësi tjetër, parashtrihen pyetje për nxënësit.

Si duket nafta? Si është formuar nafta? Ç`do të thotë emri naftë? Ç`do të thotë emri petroleum?

Si nxirret nafta?

Lexohet paragrafi i katërt, parashtrihen pyetje për nxënësit.

Si është formuar dhe çfarë është gazi natyror? Si mund ta dallojmë gazin natyror? Si përdoret gazi natyror?

Lexohet dhe paragrafi i pestë nga ndonjë nxënës, pastaj parashtrihen pyetjet edhe për këtë pjesë.

Përse janë të rëndësishme lëndët djegëse? Ku përdoren lëndët djegëse fosile? Cilat lëndë djegëse përfitohen me përpunimin e naftës? Marrim përgjigje nga nxënësit sipas nevojë plotësohen edhe nga shpjegimet e mësuesit/es.

Nga mësuesi/ja lexohen pyetjet e rubrikës, “Lexo, mendo, dhe përgjigju”, hapet diskutimi, nxënësit japin përgjigjet e tyre.

Udhëzohen nxënësit që në mënyrë individuale të shkruajnë veprimtari nga jeta e përditshme gjatë të cilave përdoren lëndët fosile. (Rubrika 2. Zbato njohuritë)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune fq.____

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

1.9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon ndotjen e mjedisit nga djegia e lëndëve fosile dhe jep ide se si mund të zvogëlohet kjo ndotje.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3,II.1, III.4,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndotja e mjedisit			
Fjalët kyçe: ndotje e mjedisit, efekti “serrë”, shi acid			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: • <i>Identifikon ndotësit e ajrit.</i> • <i>Shpjegon krijimin e shiut acid.</i> • <i>Liston faktorët që ndikojnë në ngrohjen globale.</i> Kriteret e suksesit: • <i>Identifikon me shembuj konkretë ndotësit e ajrit gjatë stinës së dimrit.</i> • <i>Sqaron krijimin e shiut acid dhe dëmeve të tij.</i> • <i>Listo dy-tre faktorë që ndikojnë në ngrohje globale.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, laps, letër, burime interneti			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon me orën me pyetjen: <i>Si mendoni, pse gjatë stinës së dimrit ajri në zonën tuaj është më i ndotur se gjatë verës?</i> Nxënësit japin përgjigjet e tyre, mësuesi/ja nxit diskutimin me anë të pyetjeve rreth ndotjes së mjedisit, dhe shkruan përgjigjet në tabelë në formë kllasteri.			
Ndotësit			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit t'i shikojnë fotografitë e paraqitura përmes projektorit (faqen e librit) apo në libër. Pyet nxënësit: <i>Si mendoni, çfarë ka ndodhur me skulpturën dhe pemët në pyll?</i> Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Ata njoftohen që të mësojnë më shumë rreth <i>shiut acid</i> dhe efektit “serrë”. Nxënësit udhëzohen të fillojnë të lexojnë paragrafin “ <i>shiu acid</i> ”. Pasi të lexojnë, mësuesi/ja u parashtrohet pyetjet: <i>Si krijohet shiu acid? Çfarë dëmsh shkaktin shiu acid në tokë?</i>			

Marrim përgjigje nga 2-3 nxënës. Shkruajmë përgjigjet e nxënësve (plotësohen nga mësuesi/ ja sipas nevojës) në tabelë. Para nxënësve shfaqet një video përmes projektorit, ku paraqitet vizualisht krijimi i shiut acid dhe dëmet e tij.

<https://www.youtube.com/watch?v=cRKQT7DeN-E>

Nxënësit udhëzohen të lexojnë edhe paragrafin *efekti “serrë”*. Pasi ta lexojnë, mësuesi/ ja parashtron pyetjet: *Çfarë është efekti “serrë”? Cilët janë faktorët që çojnë në rritjen e temperaturës në tokë?*

Marrim përgjigje nga 2-3 nxënës. Shkruajmë përgjigjet e nxënësve (plotësohen nga mësuesi/ ja sipas nevojës) në tabelë. Dhe për këtë dukuri, para nxënësve shfaqet përmes projektorit videoja ku ata do të shohin vizualisht shpjegimin e efektit “serrë”.

<https://www.youtube.com/watch?v=SN5-DnOHQmE>

<https://www.youtube.com/watch?v=DYHAZaasdxl>

Zhvillohet veprimtaria “Identifikimi i burimeve të ndotjes në vendbanimin tuaj”.

Nxënësit ndahen në dy grupe.

Grupi i parë bën një listë të burimeve të ndotjes së mjedisit nga lëndët fosile në zonën e tyre.

Grupi i dytë bën një listë me efektet negative të ndotjes së mjedisit.

Nxënësit prezantojnë hulumtimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.




DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrikat “Lexo, mendo dhe përgjigju” dhe “Zbato njohuritë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Materia, vetitë dhe shndërrimet		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon ndotjen e mjedisit nga djegia e lëndëve fosile dhe jep ide se si mund të zvogëlohet kjo ndotje.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : II.1, III.4,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shpyllëzimi			
Fjalët kyçe: ndotje, shpyllëzim, erozion			

Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi/ja: • Shpjegon ndotjen e tokës nga njeriu. • Gjykon rëndësinë e gjallesave në tokë. • Diskuton rreth ndotësit që merr bima nga toka. Kriteret e suksesit: • Shpjegon me shembuj konkretë ndotjen e tokës nga njeriu. • Sqaron rëndësinë e jetesës së gjallesave në tokë. • Diskuton rreth ndotësit që merr bima nga toka dhe ndikimit të saj në shëndetin tonë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, 1 gotë, ujë, ngjyruar ushqimor, 1 lugë, një kërcell selinoje
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja fillon me fjalinë: “Shfrytëzimi i tokës nga njeriu sot bëhet në shumë drejtime”. Pyet nxënësit: Si mendoni, çfarë ndikimi mund t’i sjellë tokës ky veprim? Merr përgjigje nga nxënësit dhe i nxit ata me pyetje për të dalë te fjalët kyçe të njësive mësimore. Mësuesi/ja shkruan në tabelë tri fjalët kyçe të njësive mësimore që do të zhvillohet. ndotje  shpyllëzim  erozion  Pyet nxënësit se çfarë dinë rreth këtyre fjalëve. Përgjigjet e sakta i shkruan pranë fjalëve përkatëse. Nxënësit udhëzohen t’i hapin librat dhe të lexojnë mësimin në f. 24. Pas përfundimit të leximit, u parashtron pyetje si: - <i>Pse është e rëndësishme toka për jetesën e gjallesave?</i> - <i>Si ndotet toka nga aktiviteti i njeriut?</i> - <i>Si ndikon shpyllëzimi në atmosferë?</i> - <i>Pse ndodh erozioni?</i> Përgjigjet e sakta të nxënësve i shkruan pranë pyetjeve në tabelë, gjithmonë duke plotësuar përgjigjet jo të plota të nxënësve. Zhvillohet veprimtaria “Hulumtimi i ndotjes në mjedis”, duke ndjekur hapat e paraqitur në libër në f. 24. Me këtë eksperiment, nxënësit shohin nga afër rolin e ndotësit që merr bima nga toka nëpërmjet ujit. Diskutohet në klasë rreth pyetjeve: - <i>Çfarë do të ndodhte me shëndetin tonë, nëse do të konsumonim një bimë që ka ndotje brenda saj?</i> - <i>Çfarë kuptojmë nga ky eksperiment?</i> Nxënësit lihen të shprehin lirshëm mendimet e tyre.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësim i vazhdueshëm.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika: “Zbato njohuritë”. Fletore pune
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

1.11

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Materia, vetitë dhe shndërrimet</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon ndotjen e mjedisit nga djegia e lëndëve fosile dhe jep ide se si mund të zvogëlohet kjo ndotje.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.1, II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Si mund të zvogëlohet ndotja e mjedisit			
Fjalët kyçe: energji diellore, energji e erës, riciklim			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Identifikon veprimet e njeriut që ndotin mjedisin. • Dallon burimet e rinovueshme dhe jo të rinovueshme të energjisë. • Klasifikon materiale të ndryshme ricikluese.			
Kriteret e suksesit:			
• Liston veprimet e njeriut që ndikojnë në ndotjen e mjedisit. • Dallon dy-tri burime të rinovueshme dhe jo të rinovueshme të energjisë. • Klasifikon materialet ricikluese sipas fotografive.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: tre kontejnerë, fotografi me objekte prej materialesh të ndryshme, laps dhe letër			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon orën duke bërë përsëritje nga njësitë e kaluara dhe u parashtrohet nxënësve pyetjen:			
<i>A mendoni se njeriu është shkaktari kryesor i ndotjes së mjedisit?</i>			
Nxënësit lihen të shprehin lirshëm mendimet e tyre.			
Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 26. Ata lexojnë në heshtje paragrafin e parë, ndërkohë mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen:			
<i>Çfarë mund të bëjmë ne për të mbrojtur plantin nga ndotja?</i>			
Merren mendime nga nxënësit dhe përgjigjet e sakta shkruhen pranë pyetjes.			

Vazhdohet leximi i paragrafit të dytë nga nxënësit *“Burimet alternative të energjisë”*, ndërkohë mësuesi/ja paraqet një tabelë ku kërkohet të identifikohen burimet e energjisë së rinovueshme dhe jo të rinovueshme.

Tabela plotësohet nga përgjigjet e nxënësve.

Burimet e rinovueshme	Burimet jo të rinovueshme

Lexohet edhe paragrafi i tretë nga nxënësit: *“Menaxhimi i mbeturinave”*.

Ndërkohë, mësuesi/ja shkruan pyetjet në tabelë.

- *Çfarë quajmë riciklim?*
- *Cilat mbeturina mund të riciklohen?*

Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit rreth pyetjeve, vazhdohet diskutimi bazuar në tabelën e paraqitur në libër, rreth produkteve që mund të fitohen gjatë procesit të riciklimit.

Nxënësit ndahen në tri grupe për të realizuar veprimtarinë: *Hulumtimi i produkteve të riciklueshme*. Udhëzohen të ndjekin hapat në libër. Grupet prezantojnë punën e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrikat *“Lexo, mendo dhe përgjigju”* dhe *“Zbato njohuritë”*.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon si, kur dhe nga kush u zbulua qeliza për herë të parë.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.8, III.1, III.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qeliza dhe zbulimi i saj			
Fjalët kyçe: qelizë, mikroskop, teoria qelizore			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
- <i>Imagjinon ndërtimin e organizmit.</i> - <i>Shpjegon se si u zbulua qeliza.</i> - <i>Demonstron punën e mikroskopit.</i>			
Kriteret e suksesit:			
- <i>Përshkruan me dy- tri fjali ndërtimin e organizmit.</i> - <i>Shpjegon me fakte se si është zbuluar qeliza.</i> - <i>Demonstron me së paku dy shembuj punën e mikroskopit dhe të lupës.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, burime interneti, mikroskopi, lupa			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të mbyllin sytë dhe të bëjnë një udhëtim imagjinar në brendësi të trupit dhe të shikojnë pjesët që e ndërtojnë atë. Më pas pyet nxënësit: <i>A mund të më thoni se cila ishte njësia më e vogël ndërtuese e trupit që takuat?</i>			
Të gjitha përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.			
Mësuesi/ja paraqet para nxënësve një video përmes projektorit, ku nxënësit do të shohin në mënyrë vizuale ndërtimin e trupit të njeriut nga një qelizë e vetme dhe funksionimin e tij.			
https://youtu.be/8vo59AKzU4Q			
Hapin librin në f. 28, udhëzohen të lexojnë njësinë mësimore në mënyrë individuale.			
Pasi të lexojnë librin, mësuesi/ja parashton pyetjet:			
- <i>Çfarë është qeliza?</i> - <i>Cili është kontributi i R. Hukut në zbulimin e qelizës?</i>			

- Çfarë zbulimi bëri A. fan Liuvenhoek?
- Cilat janë pohimet e teorisë qelizore?
Nxënësit japin përgjigje në bazë të njohurive paraprake dhe atyre të fituara. Më pas, informatat plotësohen nga mësuesi/ja.
Mësuesi/ja sjell para nxënësve mjetet e punës, si mikroskopin e lupën, dhe demonstroi para nxënësve përdorimin e tyre. Pastaj disa nga nxënësit përsërisin veprimet e mësuesit/es.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Hulumto si ka kontribuar mikroskopi në zbulimin e qelizës.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon konceptin për qelizën si term i përdorur për herë të parë të nxënësit dhe hierarkinë e ndërtimit të qenieve të gjalla (qeliza-indi-or-gani-sistemi i organeve-organizmi)</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, I.8,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Organizmat dhe larmia e qelizave të tyre			
Fjalët kyçe: organizma njëqelizorë, organizma shumëqelizorë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: - <i>Përmbledh njohuritë rreth qelizës.</i> - <i>Krahason organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë.</i> - <i>Përshkruan informacionet rreth organizmave njëqelizorë dhe shumëqelizorë.</i>			
Kriteret e suksesit: - <i>Përmbledh njohuritë e qelizës, duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara.</i> - <i>Krahason organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë bazuar në funksionet e tyre.</i> - <i>Përshkruan informacionet e marra rreth funksionimit të qelizave.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, fotografi			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja shkruan titullin e njësishë mësimore në tabelë: *“Organizmat dhe larmia e qelizave të tyre”*.

Udhëzon nxënësit të rikujtojnë njësinë paraprake *“Qelizat”*, me anë të pyetjeve:

- Çfarë është qeliza?
- Cili është roli i qelizës?
- Prej sa qelizash ndërtohen gjallesat?

Merren përgjigje nga nxënësit.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 30 dhe të lexojnë paragrafin e parë, për *“Organizmat njëqelizorë dhe shumëqelizorë”*. Pasi ta kenë lexuar, mësuesi/ja paraqet përmes projektorit, videon ose foto të ngjitura në hamer, përmes të cilave plotësohen informatat rreth organizmave njëqelizorë dhe shumëqelizorë.

https://youtu.be/1hrkwJ_HuRO

Nxënësit lexojnë paragrafin e dytë, mësuesi/ja pyet për format e qelizës. Nxënësi jep përgjigje duke u bazuar në informacionet e marra nga libri. Jepen sqarime lidhur me formën e qelizës, duke marrë shembuj nga figurat në libër për formën e saj.

Lexohet pjesa e tretë nga ana e nxënësve, analizohet nga mësuesi/ja së bashku me nxënësit fotoja ku ipen sqarime rreth madhësisë së qelizave.

Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secili grup do të ketë nga një *flipchart* të bashkangjitur nga një pyetje, ku bashkërisht në grup do të shkruajnë për pyetjen e parashtruar.

Grupi i parë ---- organizmat njëqelizorë.

Grupi i dytë ----- organizmat shumëqelizorë.

Grupi i tretë ----- ndryshimin e një qelize nga tjetra.

Grupi i katërt ----- forma dhe madhësia në punën e qelizës.

Përfaqësuesi i grupit prezanton punën e përbashkët.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Tregon disa nga funksionet dhe format që kanë qelizat në trupin tonë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon pjesët kryesore ndërtuese të qelizës (membranën, murin qelizor, bërthamën dhe citoplazmën)</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.3, III.1, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.5, 2.3			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndërtimi i qelizës shtazore			
Fjalët kyçe: qelizë shtazore, citoplazmë, bërthamë, mitokondri, qelize eukariote, qelizë prokariote			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: - Tregon për njësinë më të vogël – qelizën. - Identifikon pjesët kryesore të qelizës. - Arsyeton funksionin e organeleve të qelizës. Kriteret e suksesit: - Tregon për njësinë më të vogël - qelizën bazuar në pyetje. - Identifikon pjesët kryesore të qelizës - citoplazma, bërthama. - Arsyeton funksionin e Mitokondrisë dhe Vakuolës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>libri i nxënësit, peshore, 2 vezë, 2 gota, uthull, lugë, ujë, ujë me sheqer, cilindër i shkallëzuar</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja shtron për diskutim me nxënësit pyetjen: <i>Çfarë kemi mësuar deri tani për njësinë më të vogël të trupit, qelizën?</i> Mësuesi/ja nxit nxënësit të tregojnë gjithçka dinë për qelizën. Mësuesi/ja paraqet njësinë “Ndërtimi i qelizës shtazore”, me anë të projektorit ku paraqitet ndërtimi i qelizës shtazore. https://www.youtube.com/hashtag/science Hapin librin në f. 32, lexohet teksti nga mësuesi/ja me ndalesa. Pasi të lexohet pjesa e parë, mësuesi/ja parashtrohet pyetje: - Sa lloje qelizash kemi? - Çfarë funksioni kryejnë? Lexohet pjesa e dytë, ku mësuesi/ja parashtrohet pyetje: - Çfarë quajmë citoplazmë? - Nga çfarë përbëhet citoplazma?			

Vazhdohet me pjesën e tretë, parashtrohet pyetja: - Çfarë është bërthama? - Çfarë quajmë qelizë prokariote? Mësuesi/ja lexon edhe pjesën e katërt. Pas leximit parashtrohet pyetje për diskutim: - Cili organel i jep energji qelizës? - Po vakuola, çfarë është? Pasi diskutohen pyetjet e parashtuara, mësuesi/ja i përgatit nxënësit për veprimtarinë e paraqitur në libër. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për hapat që duhen ndjekur për realizimin e veprimtarisë. Gjatë kësaj kohe, mësuesi/ja vëzhgon nxënësit dhe i ndihmon sipas nevojës. Nxënësit udhëzohen që në mënyrë individuale të plotësojnë rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika “Zbato njohuritë” & Fletore pune
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore


2.4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon pjesët kryesore ndërtuese të qelizës (membranën, murin qelizor, bërthamën dhe citoplazmën)</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.5, 2.3			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndërtimi i qelizës bimore			
Fjalët kyçe: qelizë bimore, mur qelizor, kloroplaste, vakuolë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
- <i>Identifikon pjesët kryesore të qelizës.</i> - <i>Përshkruan funksionin e pjesëve ndërtuese të qelizës.</i> - <i>Krahason qelizat bimore dhe shtazore.</i>			
Kriteret e suksesit:			
- <i>Identifikon pjesët kryesore përmes fotografive.</i> - <i>Përshkruan funksionin e kloroplastit, vakuolës dhe murit qelizor.</i> - <i>Krahason qelizat bimore dhe shtazore sipas karakteristikave.</i>			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, fotografi, etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE



Vendosen tri fotografi në tabele, ku paraqitet kloroplasti, vakuola dhe muri qelizor.

Mësuesi/ja përgatit paraprakisht tri etiketa ku janë të shkruara definicionet për kloroplastin, vakuolën dhe murin qelizor.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskuton dhe sqaron funksionin e kloroplastit, vakuolës dhe murit qelizor.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 34 dhe të lexojnë njësinë mësimore.

Pasi të lexohet edhe teksti, nxënësit plotësojnë njohuritë e tyre rreth njësisë mësimore. Më pas udhëzohen që etiketat e paraqitura nga mësuesi/ja t'i vendosin afër secilës fotografi që i përka-sin definicionet.

Bimët, që të rriten, kanë nevojë për energji. Për këtë arsye, qelizat e tyre kanë një organel që thith energjinë diellore, të cilën e kthen në ushqim për bimët. Ky organel quhet kloroplast.

Bimët nuk mund të lëvizin për të siguruar ujin kur s'ka shi, ndaj ato duhet të jenë të afta të grumbullojnë sasi të mëdha të ujit. Në qelizën bimore gjendet një vakuolë e madhe qendrore.

Qeliza bimore ka një veshje shtesë të jashtme mbi membranën qelizore. Ky është muri qelizor.

Nxënësit analizojnë fotografitë dhe tregojnë për rolin e qelizave bimore.

Mësuesi/ja iu parashtron nxënësve pyetjet nga rubrika "Lexo, mendo dhe përgjigju", merren përgjigje nga dy-tre nxënës.

Nxënësit plotësojnë tabelën e paraqitur në tekst, ku do të vendosin një *chek* për çdo organel që gjendet në secilën prej tipave të qelizës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE



Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria: *Modelimi i qelizave të bimëve dhe kafshëve.*

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: - Shpjegon konceptin për qelizën si term i përdorur për herë të parë të nxënësit dhe hierarkinë e ndërtimit të qenieve të gjalla (qeliza,-indi-organ-sistemi i organeve-organizmi)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.1,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1,			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Nga qeliza tek organizmi			
Fjalët kyçe: qelizë, ind, organ, sistem, organizëm			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja:			
- Tregon njohuritë që ka për qelizën. - Përgjigjet në pyetjet e diskutimit rreth njësisë. - Analizon ndërtimin e organizmave.			
Kriteret e suksesit:			
- Jep së paku tri mendime rreth qelizës. - Përgjigjet saktësisht në pyetjet e parashtruara. - Analizon saktësisht ndërtimin e organizmave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fotografi, lapsa me ngjyra, fletë A4			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja iu parashtron pyetje nxënësve:			
- Çfarë është qeliza? - Çfarë quajmë organizma njëqelizorë? - Çfarë quajmë organizma shumëqelizorë?			
Me anë të pyetjeve, vijmë deri te njësia mësimore.			
Mësuesja paraqet ilustrimet në tabelë, përmes projektorit ose fotografive të printuara.			
			
qelizë	ind	organ	organizëm
Mësuesi/ja iu sqaron nxënësve si formohen indet, organet, organizmi.			

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 36 dhe të lexojnë njësinë. Fillimisht lexohet në heshtje gjithë njësia nga nxënësit. Më pas diskutohet për secilin paragraf, ku mesuesi/ja parashtron pyetje:

- Çfarë funksioni kryen qeliza?
- Si formohen indet?
- Cili është organi me i madhi i trupit?
- Cilat janë organet e bimëve?

Jepen përgjigje nga nxënësit, pastaj diskutohen ilustrimet në libër, ku janë paraqitur organet e kafshëve dhe të bimëve.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përgatisin lapsat me ngjyra dhe fleta për realizimin e veprimtarisë.

Nxënësit zgjedhin me çka të krahasojnë organizimin e trupit të njeriut, bazuar edhe në shembullin e paraqitur në libër, ku është krahasuar struktura e organizmit me atë të qytetit.

Ne formë grupore prezantohet puna e përfunduar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përgjigju pyetjeve të rubrikës: *Lexo, mendo, përgjigju.*

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Përkthyer aftësinë e shumimit të qelizave</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Riprodhimi i qelizave			
Fjalët kyçe: shumimi i qelizës			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja:			
- <i>Shpreh mendime në lidhje me pyetjet e parashtruara.</i> - <i>Përkthyer aftësinë e shumimit të qelizave.</i> - <i>Analizon ndarjen e qelizës.</i>			
Kriteret e suksesit:			
- <i>Shpreh së paku dy mendime rreth pyetjeve të parashtruara.</i> - <i>Përkthyer aftësinë e shumimit të qelizave bazuar në ilustrim.</i> - <i>Analizon ndarjen e qelizës në mitozë dhe mejozë.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, projektori			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja parashtrohet pyetjen:

- *Ju ka ndodhur të gërvishtni dorën apo këmbën?*
- *Çfarë ka ndodhur pas disa ditësh me plagën që ju është shkaktuar?*

Nxënësit udhëzohen të shprehin lirshëm, të tregojnë raste të lëndimeve dhe trajtimin e tyre. Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 38 dhe të shikojnë ilustrimin në libër, analizojnë ndarjen e qelizës, formimin e qelizave të reja nga ato ekzistuese.

Mësuesi/ja lexon tekstin duke dhënë sqarime për ndarjen e qelizave.

Në projektor paraqitet një video, ku nxënësit shohin ndarjen apo shumimin e qelizave.

<https://youtu.be/kqUp8t4co0Q>

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë pjesën “Lexo, mendo dhe përgjigju”. Lexohen përgjigjet nga dy-tre nxënës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruaj çfarë do t’i ndodhte trupit nëse qeliza s’do të kishte aftësi për t’u shumëzuar.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: - <i>Demonstron punën me mjete zmadhuese (llupë, thjerrëz, mikroskop)</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.3, II.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.2, 2.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vëzhgimi i qelizës bimore dhe shtazore me mikroskop (punë praktike)			
Fjalët kyçe: qelizë, qelizë bimore, qelizë shtazore, mikroskop			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>Përdor në mënyrë të drejtë mjetet e punës.</i> - <i>Ndjek drejt hapat e veprimtarisë.</i> - <i>Diskuton rreth preparateve të vëzhguara.</i>			
Kriteret e suksesit: - <i>Përdor në mënyrë të drejtë mikroskopin, lupën.</i> - <i>Ndjek drejt hapat e veprimtarisë sipas radhës.</i> - <i>Diskuton rreth preparateve të vëzhguara në të dy qelizat.</i>			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, një qepë, kunja me pambuk, ngjyruet ushqimor, një pjatë, thikë, lupë, mikroskop
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja iu tregon paraprakisht nxënësve mjetet e nevojshme për punë praktike. Në tabelë shkruajmë njësinë mësimore “Vëzhgimi i qelizës bimore dhe shtazore me mikroskop” Mësuesi/ja i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup do ta vëzhgojë qelizën bimore, ndërsa grupi tjetër qelizën shtazore. Ndahen mjetet e nevojshme në të dyja grupet: një qepë, kunja me pambuk, ngjyruet ushqimor, një pjatë, thikë, lupë, mikroskop. Hapin librin në f. 40-41, lexojnë udhëzimet . Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë duke ndjekur hapat e dhënë në libër. Diskutohet rreth asaj se çfarë kanë vëzhguar në të dyja preparatet me mikroskop.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës : <i>Përshkruan ndryshimet që ndodhin në pubertet</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 3.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Puberteti			
Fjalët kyçe: adoleshencë, pubertet			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: - <i>Përshkruan ndryshimet që ndodhin gjatë pubertetit.</i> - <i>Tregon kur fillon puberteti te vajzat dhe djemtë.</i> - <i>Shkruan pyetje për fazën e pubertetit.</i> Kriteret e suksesit: - <i>Përshkruaj ndryshimet kryesore që ndodhin te vajzat dhe djemtë në fazën e pubertetit.</i> - <i>Tregon saktësisht moshën kur fillon puberteti te vajzat dhe djemtë.</i> - <i>Shkruan së paku një pyetje për ndryshimet që ndodhin në pubertet.</i>			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fotografi, letër A4
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mesuesi/ja paraqet përmes projektorit fotografi, udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë për pak minuta dhe më pas jepen mendime dhe diskutojnë për atë se çka po shohin, duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga mesuesi/ja. <i>Çfarë po shihni në këtë fotografi?</i> <i>A dallojnë mes vete këta dy fëmijë?</i> <i>Cilat janë dallimet që po i vëreni?</i> Jepen përgjigje nga nxënësit. Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 42. Lexohet teksti nga mesuesi/ja me ndalesa duke parashtruar pyetje për nxënësit. <i>Cilat janë fazat e rritjes?</i> <i>Rreth cilës moshe fillon puberteti?</i> Lexohet pjesa e dytë nga mesuesi/ja, i cili parashtron pyetje për nxënësit: <i>Cilat janë ndryshimet që ndodhin në trupin e vajzave dhe djemve?</i> Mesuesi/ja lexon pjesën e tretë dhe pasi lexohet pjesa e fundit, parashtron pyetjen: <i>Si duhet të trajtohet trupi në këtë fazë?</i> Jepen përgjigje nga nxënësit. Prezantohet grafiku organizues në tabelë, plotësohet bashkërisht me nxënësit.
Përmes veprimtarisë “<i>kutia e pyetjeve</i>”, nxënësit mund të bëjnë pyetje në mënyrë anonime rreth gjerave që dëshirojnë të dinë. Pyetjet diskutohen në orën e ardhshme. Mesuesi/ja parashtron pyetje nga rubrika “<i>Lexo, mendo dhe përgjigju</i>” Jepen përgjigje nga disa nxënës.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimt.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Zbato njohuritë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare:
Shkencat e natyrësLënda:
Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: II

Klasa: V

Tema: Bota e gjallë

Rezultati i të nxënit të temës:
Dallon ndryshimet mes shoqërisë, shoqërizimit, relacioneve dhe takimeve.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.1, II.6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i pubertetit në marrëdhëniet me të tjerët

Fjalët kyçe: shoqërizimi, shoqëri, marrëdhënie, ndryshime sociale, ndryshime emocionale

Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.

Nxënësi/ja:

- Tregon për ndryshimet emocionale dhe shoqërore.
- Rendit shembuj negativë dhe pozitivë.
- Shkruan për rëndësinë e marrjes së përgjegjësisë.

Kriteret e suksesit:

- Tregon për ndryshimet emocionale dhe shoqërore duke u bazuar në përditshmëri.
- Rendit së paku tre shembuj negativë dhe pozitivë duke u bazuar në sjelljen e bashkëmoshatarëve.
- Shkruaj së paku dy arsye për të qenë i pavarur.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, flete punuese

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mesuesi/ja paraqet njësinë mësimore “Ndikimi i pubertetit në marrëdhëniet me të tjerët”.

Diskutohen pyetjet anonime të parashtruara nga nxënësit nga kutia e pyetjeve. Jepen përgjigje nga mësuesja.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 44.

Pasi hapin librin, mesuesi/ja udhëzon nxënësit të ndajnë tekstin në dy pjesë. Pjesa e parë “Ndryshimet emocionale” dhe pjesa e dytë “Ndryshimet shoqërore në pubertet”.

Nxënësit të ndarë në dyshe do të lexojnë secili pjesën e vet. Pasi lexojnë, mësuesja kërkon nga ata që të tregojnë raste (nëse kanë pasur) kur ata kanë pasur ndryshime emocionale dhe ndryshime shoqërore në pubertet. Pasi diskutohet bashkërisht me mësuesin/en, jepen informacione shtesë se si duhet menaxhuar gjendjet emocionale dhe shoqërore.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në rubrikën “Zbato njohuritë”.

Mesuesi/ja paraprakisht përgatit një flete punuese.

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë disa shembuj pozitivë dhe disa shembuj negativë nga bashkëmoshatarët që kanë ndikuar në sjelljen e tyre.

Shembuj pozitivë	Shembuj negativë

Lexohen shembujt të fleta punuese nga disa nxënës. Mesuesi/ja u shpërndan nxënësve fleta A4. Nxënësit udhëzohen të mendojnë ndonjë fushë të jetës ku do të dëshironin të kishin pavarësi dhe t'u shkruajnë letër prindërve pse do të duan të jenë të pavarur dhe çfarë përgjegjësie do të pranojnë për të treguar se je i gatshëm për të treguar se je i përgjegjshëm. Letrën e shkruar ua dërgojnë prindërve.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Përgjigjen në pyetjet e parashtruara në rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon situatat e abuzimeve seksuale, mënyrat e shmangies dhe di ku të kërkoj ndihmë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.2, II.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Si të ruhem nga abuzimet			
Fjalët kyçe: abuzim seksual, abuzim verbal, abuzim fizik, bullizëm			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - Identifikon format e abuzimit. - Përshkruan llojet e abuzimit. - Rendit rregullat e sigurisë.			
Kriteret e suksesit: - Identifikon së paku dy forma të abuzimit. - Përshkruan llojet e abuzimit duke i specifikuar veç e veç. - Tregon më së paku katër rregulla që duhet t’iu përmbahesh.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mesuesi/ja e fillon orën duke bërë përsëritje nga ora e kaluar, lidhur me pubertetin, ndryshimet emocionale dhe shoqërore. Iu bën pyetje nxënësve për të arritur të qëllimi i orës mësimore:			

Si e kuptoni termin shoqëri?

Cilat janë disa nga ndryshimet emocionale që shfaqen në pubertet?

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 46.

Mesuesi/ja udhëzon nxënësit të shikojnë ilustrimin në libër.


Pyet nxënësit:

Si mendoni, çfarë po përjeton vajza që është e abuzuar verbalisht? Cilët janë personat që e kanë sulmuar?

Jepen përgjigje nga nxënësit.

Mesuesi/ja lexon tekstin në tërësi, duke dhënë sqarime për abuzimin seksual, verbal, fizik, emocional dhe bullizmin.

Ne tabelë, mësuesja paraqet grafikun organizues për abuzimet dhe nxit nxënësit me pyetje, për ta plotësuar.



Mesuesi /ja bashkërisht me nxënësit plotësojnë grafikun organizues.

Mesuesi/ja lexon pyetjet në rubrikën “Lexo, kupto dhe përgjigju”.

Çfarë quajmë abuzim? Në çfarë formash mund të shfaqet abuzimi? Përkrahja pse duhet raportuar abuzimi.

Jepen përgjigje nga nxënësit.

Nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të shkruajnë rregullat e sigurisë të paraqitura në libër. Lexohen rregullat me zë të lartë nga disa nxënës.

2.11

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënës të temës: <i>Shpjegon faktorët mjedisorë që ndikojnë në shëndetin e njeriut përgjatë fazave të zhvillimit individual (ushqimi, marrëdhëniet sociale, substancat psiko-aktive).</i>	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës: I.3 , II.2, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2,2.3			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Njeriu dhe shëndeti			
Fjalët kyçe: <i>shëndet mendor, shëndet fizik, shëndet social</i>			

Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:

Nxënësi/ja:

- Tregon për rëndësinë e shëndetit.
- Identifikon faktorët e shëndetit.
- Vlerëson rëndësinë e emocioneve dhe ndjenjave.

Kriteret e suksesit:

- Tregon së paku dy veprime kur kujdesesh për shëndetin.
- Liston disa arsye për të përmirësuar shëndetin fizik.
- Rendit dy sjellje që përmirësojnë shëndetin social.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, ngjyrat e semaforit , burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja paraqet grafikun organizues në tabelë dhe pyet nxënësit: Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni fjalën shëndet?



Pasi të shkruhen përgjigjet e nxënësve, nxiten që të diskutojnë për faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut.

Nxënësit tregojnë për faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut, duke u bazuar në përditshmërinë e tyre.

Udhëzohen nxënësit të hapin librin në f. 48.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në dyshe dhe të lexojnë njësinë mësimore.

Pasi të kenë përfunduar leximin, hapet diskutimi.

Disa nga nxënësit do të tregojnë nga një faktor që ndikon në shëndetin tonë fizik, mendor dhe emocional.

Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur, të plotësojnë rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”. Të ndarë në dyshe, njëri nga nxënësit lexon pyetjen e parashtruar në rubrikë, kurse tjetri përgjigjet.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rikujtojnë ngjarjet e javës së kaluar dhe në bazë të këtyre sjelljeve pozitive apo negative, fytyrën e tyre ku shprehin emocionet e përjetuara.

Prezantohen para klasës, ku tregojnë arsyen e këtyre përjetimeve



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Te shkruajnë për pesë ditë radhazi për cilat aspekte të shëndetit fizik jeni kujdesur.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.12

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon faktorët mjedisorë që ndikojnë në shëndetin e njeriut përgjatë fazave të zhvillimit individual (ushqimi, marrëdhëniet sociale, substancat psiko-aktive).</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.1,V.3,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndikimi i ushqimit në shëndetin e njeriut			
Fjalët kyçe: energji, obezitet, nënpeshë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - <i>Liston ushqimet e shëndetshme dhe të pashëndetshme.</i> - <i>Krahason obezitetin dhe nënpeshën.</i> - <i>Analizon grafikun e aktiviteteve fizike.</i> Kriteret e suksesit: - <i>Shkruan së paku tri ushqime të shëndetshme dhe tri të pashëndetshme.</i> - <i>Vlerëson gjendjen e obezitetit dhe të nënpeshës duke u bazuar në ilustrim.</i> - <i>Argumenton me dy-tri fjali aktivitetet që i praktikon.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja prezanton para nxënësve llojllojshmëri të ushqimeve të shëndetshme dhe të pashëndetshme.			
Mësuesi/ja shkruan në tabelë me vizë ndarëse “Ushqime të shëndetshme” dhe “Ushqimet të pashëndetshme”, si dhe udhëzon nxënësit të hapin fletoret e tyre dhe të ndajnë në mes fletën me një vijë, ku në njërin anë të shkruajnë ushqimet e shëndetshme dhe në anën tjetër ato të pashëndetshmet.			
Ushqimet e shëndetshme		Ushqimet e pashëndetshme	
Pasi të kenë klasifikuar ushqimet, disa nxënës i lexojnë shkrimet e tyre.			
Udhëzohen nxënësit të hapin librin në f. 50.			
			

Në projektor paraqiten dy foto.
Udhëzohen nxënësit të shikojnë fotot dhe të bëjnë krahasimin e tyre. Mësuesi/ja parashtrohet pyetjen: - çfarë shihni në foton e parë dhe çfarë në të dytën?
Mësuesi/ja lexon tekstin me ndalesa dhe pas çdo ndalese, parashtrohen pyetje për nxënësit: - <i>Sa aktivitet fizik bëni gjatë ditës?</i> - <i>A ka llojllojshmëri në ushqimin tuaj të përditshëm?</i> Hapet diskutimi rreth pyetjeve të parashtuara. Lexohet pjesa e dytë dhe pas leximit, parashtrohen pyetje për diskutim: - <i>Çfarë është obeziteti?</i> - <i>Cilat janë pasojat?</i> Pas ndalesës së tretë, mësuesi/ja parashtrohet pyetje: - <i>Cilat janë pasojat e të qenit nën peshë?</i> Merren mendimet e disa nxënësve dhe diskutohet rreth tyre.
Mësuesi/ja, së bashku me nxënësit, analizon grafikun e paraqitur në tekst: “Energjia që harxhohet në një orë gjatë disa aktiviteteve”. Nxënësit tregojnë cilin prej këtyre aktiviteteve e praktikojnë më shumë. Nxënësit udhëzohen në mënyrë individuale të punojnë rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”, duke iu përgjigjur pyetje të dhëna në tekst, dhe merren përgjigje nga dy-tre nxënës.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika: “Zbato njohuritë”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

2.13

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Bota e gjallë		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon faktorët mjedisorë që ndikojnë në shëndetin e njeriut përgjatë fazave të zhvillimit individual (ushqimi, marrëdhëniet sociale, substancat psiko-aktive).</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.8, III.1,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Substancat psikoaktive, efekti i substancave të dëmshme			
Fjalët kyçe: substance psikoaktive, duhan, alkool			

Rezultati/et e të nxënës të orës mësimore:

Nxënësi/ja:

- Përshkruan karakteristikat e alkoolit dhe duhanit.
- Identifikon pasojat e alkoolit dhe duhanit.
- Gjykon dëmet e shkaktuara nga përdorimi i alkoolit dhe duhanit.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruan së paku dy karakteristika të alkoolit dhe duhanit.
- Identifikon dy apo tri pasoja që na shkakton përdorimi i alkoolit dhe duhanit.
- Analizon dëmet e shkaktuara nga përdorimi i alkoolit dhe duhanit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fotografi, kub, letra me ngjitës, projektor


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja paraqet në projektor disa foto.

Nxënësit udhëzohen të shikojnë fotografitë dhe thonë çfarë kanë të përbashkët këto produkte?

Pasi të analizojnë fotografitë dhe të dallojnë ato produkte, mësuesi/ja paraqet në tabelë një organizues grafik



Shkruhen të veçantat dhe të përbashkëtat e duhanit dhe alkoolit.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librin në f. 52 dhe të lexohet teksti me vëmendje. Më pas, nxënësve u shpërndahet nga një fletë A4 të ndarë në mes, ku në njërin anë do të shkruajnë “Rreziku nga duhanpirja” dhe në anën tjetër “Rreziku nga alkooli”. Dy-tre nxënës paraqesin shkrimet e tyre para klasës dhe diskutohet rreth tyre. Mësuesi/ja plotëson përgjigjet e nxënësve sipas nevojës.

Mësuesi/ja paraprakisht përgatit një kub, në faqet e të cilit vendos etiketa ku shkruan pyetjet e parashtruara në tekst te pjesa “Lexo, kupto dhe përgjigju”.

- Çfarë quajmë substancë psikoaktive?
- Si mund të ndikojë duhani në pamjen e një individi?
- Çfarë ndikimi negativ ka duhani në trup?
- Si ndikon alkooli në shëndetin e një individi?
- A ka ngjashmëri midis duhanit dhe alkoolit? Po ndryshime?

Nxënësit ndahen në grupe dhe prej secilit grup dalin nga dy përfaqësues. Njëri nga nxënësit hedh kubin dhe lexon pyetjen, nxënësi tjetër përgjigjet në pyetjen e caktuar (përgjigjja mund të merret edhe nga anëtarët e tjerë të grupit). Kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen përmes vlerësimit të vazhdueshëm dhe komenteve konstruktive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Zbato njohuritë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shken- cat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Matja e madhësive themelore në fizikë (mat me pajisjet përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Përkufizon gjatësinë, paraqet njësinë matëse të saj, lidhjen mes nënfishave dhe shumëfishave dhe shembuj të matjes nga jeta e përditshme.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Madhësitë fizike dhe matja e tyre			
Fjalët kyçe: <i>madhësi fizike, matje, njësi matëse, aparat matës</i>			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
• Shpjegon mënyrat e matjes. • Tregon përdorimin e mjeteve matëse. • Përcakton vlerën e madhësisë fizike.			
Kriteret e suksesit:			
• Shpjegon mënyrat e matjes duke u bazuar në ilustrime. • Tregon për përdorimin e mjeteve matëse në përditshmëri. • Përcakton vlerën e tri madhësive fizike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fotografi, projektor			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja paraqet fotografi të objekteve që na rrethojnë përmes projektorit.			
			
Pyeten nxënësit: <i>Me çfarë bëhet matja e objekteve? Si e bëjmë matjen e lëvizjes së makinës?</i>			
Jepen përgjigje nga nxënësit duke u plotësuar me informata shtesë nga mësuesi/ja.			
Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë: <i>“Madhësitë fizike dhe matja e tyre”</i>			

Udhëzohen nxënësit të hapin librin në fq. 54, mësuesi/ja lexon tekstin të ndarë në paragrafë. Pasi lexon pjesën e parë, parashtron pyetje: *Si e gjejmë vlerën numerike të madhësive?* Jepen përgjigje nga nxënësit.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjet, udhëzon nxënësit të përgjigjen në pyetjet e parashtruara dhe të shkruajnë në fletoret e tyre.

- Çfarë matim kur udhëtojmë me makinë?
- Kur jemi të sëmure, çfarë matim?
- Çfarë matim kur blejmë fruta?

Mësuesi/ja lexon paragrafin e fundit, duke u shpjeguar nxënësve për masën dhe vlerën. Nëse masa është 12 kg, 12 është vlera kurse kg (kilogrami) është njësia.

Mësuesi/ja paraqet video për mjetet matëse përmes projektorit.

<https://youtu.be/zz-cVbstGo0>

Nxënësit udhëzohen të tregojnë raste kur i kanë përdorur mjetet matëse në përditshmëri.

Udhëzohen nxënësit të përgjigjen në rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

Mësuesi/ja paraprakisht përgatit fletë punuese, ku do të plotësojnë kolonat bosh.

Prezantohet puna nga nxënësit dhe krahasohet me ato të shokëve.

Madhësia fizike	Aparati matës	Njësia që përdoret
Gjatësia		
Temperatura		
Masa		
Koha		

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Jepet rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shken- cat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Matja e madhësive themelore në fizikë (mat me pajisje përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron përcaktimin e masës së trupit me peshore dykrahëshe, njësinë matëse dhe lidhjen mes dërhemëve më të vegjël të saj.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, II.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjatësia dhe matja e saj			
Fjalët kyçe: <i>gjatësi, largësi, gjerësi, lartësi, trashësi, përmasë, decimetri, centimetri, milimetri, kilometri, kalibri, mikrometri</i>			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
• Demonstron përcaktimin e përmasave të trupave. • Emërton përmasat e trupave. • Zgjedh trupat për matje.			
Kriteret e suksesit:			
• Demonstron për dy a më shumë trupa përcaktimin e përmasave të tyre. • Emërton së paku dy përmasa të trupave. • Zgjedh së paku tre trupa për caktimin e përmasave të tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, peshore, termometër, metër, fletë A4, trupa të ndryshëm.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja sjell në klasë peshore, metër, termometër.			
Paraqiten para nxënësve, parashtron pyetje: <i>Çfarë matim me peshore, me metër dhe me ter- mometër?</i>			
Pasi jepen përgjigje nga nxënësit, mësuesi/ja peshon masën e çantave, masën trupore te nx- ënësve; me metër mat bankën, tabelën, si dhe me termometër demonstrojnë matjen e tem- peraturës trupore. Vlerat e matjes i shkruan në tabelë.			
Përmes aktivitetit, mësuesi/ja arrin deri te njësia mësimore: <i>“Gjatësia dhe matja e tij”</i> .			
Udhëzohen nxënësit të hapin librin në f. 56, njësia mësimore lexohet duke e ndarë në paragrafë.			
Njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë me zë, udhëzohen nxënësit të analizojnë ilustrimet në libër.			



Mësuesi parashtron pyetje: Çfarë fjale përdorim kur shohim një libër të trashë? Po madhësinë ndërmjet dy trupave, si e quajmë?

Mësuesi/ja paraqet një kub, u shpjegon nxënësve se ai ka gjatësinë, gjerësinë dhe lartësinë.

Jepen përgjigje nga nxënësit.

Lexohet me zë paragrafi i dytë nga një nxënës, mësuesi/ja parashtron pyetje: Cilat janë pajisjet që përdorim për matjen e përmasave të trupave? Cilët janë nënfishat më të vegjël se metri?

Mësuesi/ja shkruan në tabelë njësitë më të mëdha dhe më të vogla të metrit.

Diskutohen bashkërisht me nxënësit.

Udhëzohen nxënësit të zgjedhin trupa të ndryshëm, përmasat e të cilëve do t'i matin dhe me vlerat e gjetura gjatë matjes do të plotësojnë tabelën e paraqitur në fletë A4, të përgatitur para-prakisht nga mësuesi/ja.

Trupat	Gjatësia (njësia)	Gjerësia (njësia)	Lartësia (njësia)

Pas përfundimit, mësuesi/ja parashtron pyetjen për diskutim: Çfarë mësuat?

Nxënësit diskutojnë rreth përmasave të trupave.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Jepen rubrikat: “Zbato njohuritë”, “Lexo, mendo dhe përgjigju”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
- Tema: Matja e madhësive themelore në fizikë (mat me pajisje përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron përcaktimin e njësisë matëse të lëngjeve me ndihmën e vëllimit të kubit me brinjë 1 dm.</i> <i>Demonstron përcaktimin e vëllimit të trupit të parregullt.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.7, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 2.3, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vëllimi dhe matja e tij			
Fjalët kyçe: vëllimi, litri, metri kub, decimetri kub, centimetri kub, decilitri, mililitri, enë të shkallëzuara			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: • Dallon madhësitë fizike. • Identifikon njësinë matëse të vëllimit. • Demonstron matjen e vëllimit. Kriteret e suksesit: • Dallon madhësitë fizike dhe instrumentet matëse. • Identifikon njësinë matëse të vëllimit dhe nënfishat e tij. • Demonstron matjen e vëllimit duke përcaktuar vëllimin e së paku një trupi të ngurtë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, trupa të ndryshëm të ngurtë, enë të shkallëzuara, letër, laps			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja parashtrohet pyetje nga njësitet e mësuara, si: - Çfarë është madhësia fizike? - Ç'quajmë matje? - Çfarë është gjatësia? - Si matet gjatësia?			

Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit, vazhdohet me pyetjet si:

- Çfarë është vëllimi?
- Si mendoni, a është madhësi fizike vëllimi?

Marrim përgjigje nga nxënësit, të cilat shkruhen në tabelë (*Vëllimi është madhësi fizike. Shpreh hapësirën që zë një trup i lëngët, i ngurtë apo i gaztë*).

Mësuesi/ja jep sqarime rreth vëllimit dhe matjes së tij, shkruhen njësitë matëse të vëllimit në tabelë (*metër kub (m^3), decimetër kub (dm^3), centimetër kub (cm^3), $1 m^3 = 1\,000 dm^3$; $1 dm^3 = 1\,000 cm^3$; Litri l, $1 l = 1 dm^3 = 1000 cm^3$).*

Udhëzohen nxënësit t'i hapin librat f.59 dhe të lexojnë njësinë mësimore për 10 min.

Mësuesi/ja bën matjen e vëllimit të një trupi të ngurtë (gurit) para nxënësve, sipas udhëzimeve të paraqitura në libër.

Realizohet veprimtaria e matjes së vëllimit të trupave, kërkohet nga nxënësit që të bëjnë matjen e vëllimit të ndonjë trupi të ngurtë, duke ndjekur hapat e kërkuar në libër.

Sipas nevojës, mësuesi/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit për të realizuar veprimtarinë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shken- cat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Matja e madhësive themelore në fizikë</i> <i>(mat me pajisje përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron përcaktimin e masës së trupit me peshore dykrahëshe, njësinë matëse dhe lidhjen mes dërhemëve më të vegjë të saj.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.3, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Masa dhe matja e saj			
Fjalët kyçe: masa, kilogram, gram, miligram, elektronike, kandar			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Parashikon masën e trupave të paraqitur. • Identifikon njësinë matëse të masës. • Demonstron matjen e masës.			
Kriteret e suksesit:			
• Parashikon masën e trupave: atë të topit të futbollit dhe të tenisit. • Identifikon njësinë matëse të masës dhe nënfishat e saj. • Demonstron matjen e masës në peshore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, top tenisi, top futbollit, oriz, enë plastike, peshore, laps, letër.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Mësuesi/ja prezanton para nxënësve topin e tenisit dhe atë të futbollit, dhe u drejton nxënësve pyetjet:

- Cili është më i rëndë: topi i futbollit apo topi i tenisit?
- Cili prej tyre ka masë më të madhe?

Nxënësit japin supozimet e tyre.

Mësuesi/ja iu shpjegon atyre që: *Masa është një madhësi tjetër fizike.*

Vazhdon me parashtrimin e pyetjeve për nxënësit:

- Çfarë përdorim për të matur masën e trupave?

Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit, mësuesi/ja vendos mbi bankë peshoren dhe matet masa e topave.

Pra, njësia e matjes së masës është kilogrami (kg).

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat në fq. 60 dhe të lexojnë njësinë e re mësimore për 5 min. Pas leximit, mësuesja nxit diskutimin duke parashtruar pyetje si:

- Cilat janë njësitë më të vogla se kilogrami?
- Cilat janë njësitë më të mëdha se kilogrami?
- Çfarë përdorim për të matur masën e një trupi?
- Cilat lloje të peshoreve kemi?

Marrim përgjigje nga nxënësit për pyetjet e parashtruara.

Mësuesi/ja paraprakisht sjell në klasë oriz, enë plastike dhe peshore kuzhine. Nxënësve iu jepen sqarime rreth realizimit të veprimtarisë së paraqitur, dhe në libër, udhëzohen nxënësit t'i ndjekin hapat e dhënë për të realizuar matjen e orizit.

Gjatë realizimit të veprimtarisë, mësuesi/ja vëzhgon, këshillon dhe ndihmon nxënësit sipas nevojës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Matja e madhësive themelore në fizikë (mat me pajisje përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Paraqet njësinë e matjes së kohës, njësitet më të mëdha dhe lloje të ndryshme të pajisjeve për matjen e saj.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4, I.5, II.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Koha dhe matja e saj			
Fjalët kyçe: koha, minuta, kronometri, sekonda, ora, metronomi, dekada, shekulli.			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Tregon për matjen e kohës. • Diskuton për njohuritë e reja. • Paraqet matjen e kohës.			
Kriteret e suksesit:			
• <i>Tregon dy-tre shembuj si matet koha.</i> • Diskuton për njohuritë e lexuara në tekst. • <i>Paraqit matjen e kohës me anë të veprimtarisë.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, laps, letër, spango.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja parashton pyetje:			
• Çfarë është koha? • Si matet koha?			
Nxënësit japin përgjigjet e tyre me njohuritë nga përditshmëria për matjen e kohës, në tabelë mësuesi/ja shkruan: “Koha dhe matja e saj”.			
Nxënësit udhëzohen të hapin librin në fq. 62.			
Nxënësit njoftohen se do të mësojnë për matjen e kohës, duke i udhëzuar ata që leximi të bëhet me paragrafë.			
Njëri nga nxënësit lexon me zë paragrafin e parë. Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kanë kuptuar nga leximi, pastaj jep shpjegime për kohën si madhësi fizike.			

Lexohet paragrafi i dytë, diskutohet me nxënësit se çfarë kanë kuptuar dhe jepen sqarime për ndarjen e ditës dhe natës në 24 pjesë të barabarta.

Lexohet deri në fund teksti i ndarë në paragrafë.

Mësuesi/ja jep sqarime për ndarjen e orës në minuta dhe sekonda, si dhe për përdorimin e kronometrit dhe metronomin.

Mësuesi/ja paraqet përmes projektorit ose në letër llojet e ndryshme të orëve, si: orë mekanike, orë elektronike, orë me rërë, orë diellore.



Bashkërisht me nxënësit, flasim për përdorimin e orëve me rërë, diellore, elektronike dhe mekanike.

Mësuesi/ja lidh në një skaj sferën me një fije që të lëkundet lirshëm. Udhëzohen nxënësit që të numërojnë lëvizjet e sferës dhe kohën ta matin me orë. Numrin e lëkundjeve dhe kohën i shkruajnë në fletë.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përgjigjen në pyetjet e parashtruara në rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësojnë rubrikën “Zbato njohuritë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Matja e madhësive themelore në fizikë (mat me pajisje përkatëse: gjatësinë, masën, vëllimin, kohën dhe temperaturën)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>- Përshkruan parimin e krijimit të shkallës së Celsiusit dhe dallon termometrat për matjen e temperaturës së njeriut, për bujqësi dhe meteorologji.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1, I.4,I.5, II.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Temperatura dhe matja e saj			
Fjalët kyçe: ftohtë, ngrohtë, temperatura, termometri, grada celsius.			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Përshkruan temperaturën e ambientit. • Dallon termometrat për matje. • Shpjegon temperaturën e ujit.			
Kriteret e suksesit:			
• Përshkruan temperaturën e ambientit në klasë dhe jashtë saj. • Dallon termometrin mjekësor dhe termometrin e zakonshëm. • Krahason temperaturën e ujit në bazë të shembullit në tekst.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Bashkëbisedohet me nxënësit për temperaturën që mbizotëron në klasë dhe jashtë klasës. Më pas i fton ata të përshkruajnë nëse është ftohtë apo ngrohtë.			
Nxënësit njihen me njësinë mësimore <i>“Temperatura dhe matja e saj”</i>			
Udhëzohen nxënësit të hapin librin në fq. 64.			
Lexojnë në mënyrë individuale tekstin dhe pasi ta kenë lexuar, mësuesi/ja iu parashtron pyetje:			
• Si matet temperatura? • Si është i ndërtuar një termometër i zakonshëm? • Si është i ndërtuar një termometër mjekësor?			

Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa nga përgjigjet, gjithmonë duke i nxitur nxënësit me pyetje që të plotësojnë njëri-tjetrin.

Paraprakisht ka përgatitur tri ene: në të parën hedh ujë të nxehtë, në të dytën ujë të ngrohtë dhe në të tretën ujë të ambientit. Udhëzoni nxënësit të fusin njëërën dorë në ujin e ngrohtë; njëërën në ujin e ftohtë; pastaj të dyja duart në ujin e ambientit.

Mësuesi/ja parashtrohet pyetje:

- Çfarë ndieni në duar?
- Si ndihet uji i ambientit nga dora që ishte në ujin e ngrohtë?

Nxënësit udhëzohen të tregojnë për ndjesinë gjatë provës.

Përmes projektorit, mësuesi/ja paraqet video për temperaturën dhe matjen e saj.

https://youtu.be/_3gjRvX-Yfk

Udhëzohen nxënësit të përgjigjen në rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtari: Gjetja e temperaturës mesatare.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)</i>		Rezultati i të nxënit të temës : - <i>Dallon me shembuj lloje të ndryshme të punëve në fizikë nga punët mendore.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.4, II.8, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Puna në fizikë. Fuqia			
Fjalët kyçe: puna, zhvendosje, kuaj fuqi, xhaul, fuqia			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Dallon punët fizike nga ato mendore. • Diskuton për punën në fizikë. • Rendit mjetet nga më e fuqishmja deri tek ajo më pak e fuqishmja.			
Kriteret e suksesit:			
• <i>Krahason</i> me shembuj konkretë punët fizike nga ato mendore. • Diskuton në grup për punën në fizikë. • Arsyeton renditjen e mjeteve nga më e fuqishmja deri tek ajo më pak e fuqishmja.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
<i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit, të ndarë në dyshe, të dalin në mes të klasës, ku janë vendosur paraprakisht disa objekte, p.sh. bankë, karrige.			
Nxënësit zhvendosin objektet nga një vend në një vend tjetër, duke i shtyrë ato. Pasi të përfundojnë aktivitetin, parashtrojnë pyetje: A keni përdorur forcën për shtyrje? Marrim përgjigje nga nxënësit.			
Në tabelë, mësuesi/ja paraqet njësinë mësimore “ <i>Puna në fizikë. Fuqia</i> ”.			
Nxënësit udhëzohen të hapin librin në fq. 66. Leximi i njesisë do të bëhet në mënyrë individuale, informacionet që i kanë të njohura i shënojnë me , informacionet e reja me “+”, me “?” gjërat e paqarta. Pas leximit, për 3-4 min. hapet diskutimi mes nxënësve për gjërat që i kanë kuptuar dhe ato që kanë qenë të paqarta. Pjesët që nuk kanë arritur t’i kuptojnë, ia paraqesin mësuesit/es si grup.			

Kështu veprohet me secilin grup.

Mësuesi/ja parashton pyetje:

- Çfarë është puna?
- Si përcaktohet puna?
- Çfarë është fuqia?
- Në cilin rast një forcë kryen punë në një trup?
- Çfarë tregon fuqia e një trupi të aftë për të kryer punë?

Nxënësit japin përgjigje në bazë të njohurive të mëparshme dhe atyre të nxëna nga njësia mësimore.

Mësuesi/ja paraqet fotografi të ndryshme për secilin grup, udhëzohen të bëjnë renditjen e tyre nga më e fuqishmja deri tek ajo më pak e fuqishmja.



Udhëzohen nxënësit të prezantojnë punën e tyre. Gjatë prezantimit, nxiten të tregojnë edhe përvoja të tjera nga jeta e përditshme për këta trupa.

VLERËSIMI I NXËNËSVE



Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrika “Zbato njohuritë”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda:Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Prezanton shembuj nga jeta e përditshme për lloje të ndryshme të energjive mekanike.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.1, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Puna dhe energjia mekanike			
Fjalët kyçe: energji, energji mekanike, energji e lëvizjes, energji e ruajtur			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Diskuton për punën dhe energjinë. • Dallon llojet e energjisë. • Prezanton format e energjisë mekanike.			
Kriteret e suksesit:			
• Përgjigjet së paku në njërën nga pyetjet e parashtruara. • Dallon 2 lloje të energjisë. • Prezanton një prej formave të energjisë mekanike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, figura trupash, laps, letër.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja iu rikujton nxënësve njësinë paraprake “ <i>Puna në fizikë</i> ”.			
Parashtrohen pyetje:			
• Si është ndarë puna? • A duhet të kemi energji për të punuar?			
Marrim përgjigje nga nxënësit.			
Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë: “ <i>Puna dhe energjia mekanike</i> ”.			
Nxënësit nxiten të shprehin mendimet e tyre për punën dhe energjinë.			
			

Shkruajmë përgjigjet e nxënësve në formë kllasteri.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin fq. 68.

Mësuesi/ja iu tregon nxënësve se teksti do të lexohet me ndalesë; pas çdo ndalese do të mbyllet libri dhe do të parashtrohen pyetje.

Lexohet pjesa e parë dhe parashtrohet pyetja: *Çfarë aktivitetesth bëni gjatë ditës?*

Nxënësit japin mendimet e tyre.

Hapet libri dhe lexohet pjesa e dytë, pyesim nxënësit: *Ku e gjejmë energjinë?* Sa herë në ditë ushqeheni dhe nëse nuk ushqeheni, a jeni në gjendje të keni aktivitete?

Lexohet pjesa e tretë, parashtrohet pyetja: *Cilat janë llojet e energjisë?*

Dëgjojmë përgjigjet e nxënësve.

Mësuesi/ja plotëson nxënësit me njohuri shtesë, si dhe me shembuj nga jeta e përditshme.

Nxënësve iu shpërndahen figura trupash të ndryshëm që kanë energji dhe nga një letër ku ata do të ndërtojnë një tabelë dhe do ta plotësojnë. Puna kryhet në grup. Secili grup prezanton punën e tij, duke prezantuar shembuj të energjisë mekanike nga jeta e përditshme. Mësuesi/ja i nxit nxënësit t'i bëjnë pyetje grupit prezantues.

Në fletore do të shkruajnë pyetjet dhe do të përgjigjen nga rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotësohet rubrika “Zbato njohuritë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: - <i>Vë në dukje pajisje për shfrytëzimin e energjisë diellore.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: <i>Energjia diellore dhe përdorimi i saj</i>			
Fjalët kyçe: energjia diellore, energjia e ripërtëritshme, panele diellore, pilat diellore.			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
- Diskuton për rëndësinë e energjisë.			
- Përgjigjet për pyetjet e parashtruara.			
- Përshkruan procesin e ngrohjes.			
Kriteret e suksesit:			
- Tregon se paku dy lloje të energjisë që i përdor.			
- U përgjigjet së paku dy pyetjeve të formuluar nga grupi.			
- Përshkruan procesin e ngrohjes në bazë të pamjeve në video.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, fletorja, projektori			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të flasin për energjinë në përgjithësi, përsërisim njohuritë për energjinë nga ora e kaluar.			
- <i>A mund të jetojmë pa energji? Pse?</i>			
- <i>Çfarë lloj energjish kemi?</i>			
- <i>Si e fitojmë energjinë?</i>			
Përgjigjet e nxënësve i diskutojmë bashkërisht, duke i nxitur që të tregojnë për llojet e energjisë që i përdorin.			
Nxënësit hapin librin në f. 71. Pasi të kenë hapur librin, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë në heshtje njësinë mësimore. Nxënësve të ndarë në grupe iu shpërndahet nga një <i>flipchart</i> , në të cilin do të shkruajnë gjithçka iu intereson për energjinë diellore.			

Njëri nga përfaqësuesit e grupit 1 del dhe i lexon pyetjet, grupi 2 përgjigjet. Vazhdohet me grupet e tjera, duke i lexuar pyetjet, teksa grupet e tjera përgjigjen.

Nxënësit plotësohen me njohuri shtesë nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja, përmes projektorit, paraqet video ku jepen informacione për energjinë diellore.

<https://youtu.be/inPtRWtvDaM>

Bashkërisht me nxënësit, diskutohen pamjet në video. Nxënësit udhëzohen të përshkruajnë se si bëhet ngrohja e ambienteve nga energjia diellore. Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjet nga rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju”. Nxënësit i shkruajnë në fletoret e tyre dhe u përgjigjen pyetjeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria: “Energjia diellore”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>- Shpjegon shfrytëzimin e energjisë së ujit, erës, të biomasës dhe ujërave termale.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, II.1, II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Energjitë e ripërtëritshme hidrike			
Fjalët kyçe: energji e pastër, lëndë djegëse fosile, turbinë, gjenerator, energjia hidrike, baticë.			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - Tregon mënyrat e ruajtjes së ambientit. - Dallon energjinë e ripërtëritshme nga ajo e paripërtëritshme. - Përshkruan llojet e energjisë. Kriteret e suksesit: - Tregon së paku një mënyrë se si mund të ndikojmë në ruajtje të mjedisit. - Rendit përparësitë e energjisë së ripërtëritshme. - Përshkruaj një prej llojeve të energjisë.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, <i>flipchart</i> , laps.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja paraqet në tabelë një pyetje për diskutim: <i>A mund të ndikojmë në mosndotjen e mjedisit dhe çfarë mund të bëjmë?</i> Po? Jo? Pse? Udhëzohen nxënësit që për 10 minuta të diskutojnë dhe të arsyetojnë mendimet e tyre. Disa nga përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë, më anë të pyetjes vijmë deri te njësia mësimore. Mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore: <i>Energjitë e ripërtëritshme hidrike</i>. Nxënësit udhëzohen të hapin librin në fq. 72. Mësuesi/ja lexon tekstin me paragrafë, duke parashtruar pyetje pas çdo paragrafi dhe, pas leximit të pjesës së parë, iu shpjegon nxënësve se energji e rinovueshme ose ripërtëritshme është ajo energji që nuk shteron. Ai/ajo parashtron pyetjen: <i>Cila nga energjitë nuk shteron?</i> Nxënësit nxiten të japin përgjigje. Lexohet pjesa e dytë. Mësuesi/ja iu shpjegon nxënësve se lëndët djegëse fosile, pas përdorimit apo djegies, zhduken përgjithmonë. Mësuesi/ja parashtron pyetjen: <i>Cilat lëndë djegëse i përdorni në shtëpitë tuaja?</i> Lexohet pjesa e tretë. Mësuesi/ja iu shpjegon nxënësve se energjia hidrike është një energji e ripërtëritshme, të cilën e zotëron uji që rrjedh nga diga apo lumi. Mësuesi/ja lexon pjesën e fundit, duke iu sqaruar nxënësve se energjia e valës dhe e baticës çlirohet nga valët e oqeanit, si dhe nga baticat. Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht fletë punuese, ku në njërën anë shkruan “<i>Energjia e ripërtëritshme</i>” dhe në anën tjetër “<i>Energjia e paripërtëritshme</i>”. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të arsyetojnë në lidhje me klasifikimin e llojeve të energjisë. Pasi përfundojnë, nxënësit udhëzohen të prezantojnë punë e tyre.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen për klasifikimin e llojeve të energjisë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Veprimtari: “ <i>Energjitë e ripërtëritshme hidrike</i> ”
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.11


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)		Rezultati i të nxënësve të temës: - Paraqet shembuj të mënyrave të bartjes së energjisë në natyrë.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1, II.8.
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 1.5
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Të tjera energji të ripërtëritshme
Fjalët kyçe: energji e erës, turbinë, biomasë, fotosintezë, energji gjeotermale, gejzer.
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: - Krahason energjinë e ripërtëritshme dhe atë të parinovueshme. - Tregon përdorimin e energjisë së erës. - Argumenton përdorimin e energjisë të ripërtëritshme dhe të parinovueshme. Kriteret e suksesit: - Krahason së paku dy lloje të energjisë. - Tregon përdorimin e energjisë së erës përmes ilustrimit. - Argumenton përdorimin e energjisë të ripërtëritshme dhe të parinovueshme.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, laps, letër
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja paraqet në tabelë diagramin e Venit, udhëzon nxënësit të tregojnë cilat janë të veçantat dhe të përbashkëtat e energjisë së ripërtëritshme dhe energjisë së parinovueshme. Së bashku me nxënësit, plotësohet diagrami i Venit. Nxënësit njoftohen se do të mësojnë për energji të tjera të ripërtëritshme. Udhëzohen të hapin librin në f. 74. Lexohet me paragrafë. Njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë me zë. Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë kuptuan nga leximi dhe sqaron se si përdoren mullinjtë e erës. Lexohet paragrafi i dytë, diskutohet me nxënësit se çfarë kanë kuptuar dhe shpjegohen termat “turbinë” dhe “helikë”, duke u bazuar edhe në ilustrimet e paraqitura në tekst. Lexohet paragrafi i fundit, mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kuptuan dhe sqaron termat “biomasë” dhe “gjeotermale”. Në tabelë, mësuesi/ja paraqet përmes klasterit llojet e biomasës; nxënësit e përshkruajnë në fletoret e tyre. Ai/a jo shkruan në tabelë pyetjet e rubrikës “Lexo, mendo, përgjigju”; nxënësit i përshkruajnë dhe përgjigjen. Lexohen disa prej tyre. Mësuesi/ja shkruan në tabelë një pyetje me përgjigje “Po” ose “Jo”. <i>A është e nevojshme që njerëzit që udhëheqin shtetin tonë të punojnë më shumë që ne të shfrytëzojmë më shumë energjinë e ripërtëritshme?</i> Nxënësit ndahen në çifte, mësuesi/ja iu shpërndan nga një fletë, të cilën do ta ndajnë në mes. “Po” / “Jo” Në pjesën “Po” renditen përgjigjet dhe argumentet pse duhet të punojnë më shumë për energjinë e ripërtëritshme, kurse në pjesën “Jo” pse nuk duhet. Në klasë formohen tri grupe, ata për “Po”, për “Jo” dhe ata që janë të pavendosur. Diskutojnë për 5 min. dhe japin argumentet e tyre.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Veprimtaria: “Energjia e ripërtëritshme e erës”. Zbato njohuritë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.12

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>- Demonstron me shembuj kalimin e nxehtësisë nga lënda e nxehtë në lëndën e ftohtë dhe arritjen e baraspeshimit termik</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1,II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Nxehtësia dhe transferimi i saj			
Fjalët kyçe: nxehtësi, temperaturë, gjendje agregate, energji termike, baraspeshë termike, përçueshmëri termike.			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Jep mendim për nxehtësinë dhe temperaturën. • Shpjegon ndryshimin e temperaturave të dy trupave. • Argumenton baraspeshën termike.			
Kriteret e suksesit:			
• Jep së paku një mendim për temperaturën dhe nxehtësinë. • Shpjegon ndryshimin e trupave në bazë të shpejtësisë së molekulave. • Argumenton me së paku një shembull baraspeshën termike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, tabela, enë me ujë të nxehtë dhe të ftohtë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja paraqet në tabelë dy fjalë: <i>Nxehtësia</i> dhe <i>Temperatura</i> . Me anë të pyetjeve, nxësim nxënësit të tregojnë çfarë dinë për këto dy terma.			
Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.			
Nxënësit hapin librin në fq. 76. Mësuesi/ja lexon pjesën e parë, iu sqaron nxënësve se nxehtësia dhe temperatura janë të lidhura ngushtë mes tyre, por nuk është e njëjta gjë.			
Mësuesja fton nxënësit të shikojnë një shembull demonstrues: merr një enë me ujë që ka arritur pikën e vlimit dhe një enë me akull. Në enën me ujin e vluar themi që sa më e shpejtë të jetë lëvizja e molekulave, aq më e lartë është temperatura dhe energjia e trupit.			

Lexohet pjesa e dytë, duke iu sqaruar nxënësve se nëse dy trupa me temperatura të ndryshme takohen mes tyre, ndodh një transferim energjie. Ftohen nxënësit të shohin një shembull demonstrues.



Nëse enën që ka arritur pika e vlimit dhe atë që ka akull i bëjmë bashkë, atëherë kemi bërë transferim të energjisë. Kjo energji quhet *energji termike*.

Pasi të kenë parë shembujt demonstrues, mësuesi/ja parashtron pyetje për nxënësit:

- Kur arrihet baraspesha termike në mes dy trupave?
- Cili është dallimi mes nxehtësisë dhe temperaturës?

Nxënësit japin mendimet dhe argumentet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria: “Energjia termike”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.13

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon disa nga aktivitetet që kryhen në stacionin meteorologjik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : II.4, III.1, III,4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.4, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Moti dhe matjet për të			
Fjalët kyçe: moti, reshjet, retë, era, meteorologji, klima, anemometri, flugeri, barometri, higrometri, pluviometri, termometri			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• Diskuton rreth motit. • Identifikon instrumentet për matjen e kushteve atmosferike. • Demonstron një instrument meteorologjik.			
Kriteret e suksesit:			
• Diskuton rreth motit dhe faktorëve të tij. • Identifikon instrumentet për matjen e kushteve atmosferike dhe përdorimin e tyre. • Ndërton flugerin si instrument meteorologjik, duke demonstruar punën e tij.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, karton, laps me gomë në fund, gjilpërë me kokë, pjatë polisteroli, pipëz.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon orën duke iu parashtruar nxënësve pyetje:			
• Si është moti sot? • Çfarë kuptojmë me fjalën mot?			
Merren përgjigje nga nxënësit dhe plotësohen nga mësuesi/ja sipas nevojës, për të nxjerr definicionet e sakta, të cilat shkruhen në tabelë.			
• Moti shpreh gjendjen fizike të atmosferës. • Ai përcaktohet nga disa faktorë, si: temperatura, reshjet, retë dhe era.			
Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të lexojnë tekstin për 10 min. në fq. 78. – Moti dhe matjet për të.			

Pasi të kenë lexuar, diskutohet rreth asaj çfarë kanë kuptuar dhe, së bashku, bëjnë një përmbledhje, duke i shkruar përgjigjet në tabelë:

- Shkenca që merret me studimin e motit quhet meteorologji.
- Moti tregon ndryshimet e përditshme që ndodhin në atmosferë.
- Klima tregon konditat atmosferike mesatare të një rajoni të caktuar, për një periudhë të gjatë kohore.
- Stacionet meteorologjike matin temperaturën, lagështinë, shtypjen atmosferike, sasinë e reshjeve, si dhe shpejtësinë dhe drejtimin e erës.
- Anemometri shërben për matjen e shpejtësisë së erës.
- Flugeri është instrument që tregon drejtimin e erës.
- Barometri është instrument që shërben për matjen e presionit atmosferik.
- Higrometri është instrument që përdoret për të matur lagështirën apo sasinë e avujve të ujit në ajër.
- Pluviometri është instrument që shërben për të matur sasinë e reshjeve të shiut në një zonë, për një periudhë të caktuar kohe.

Realizohet veprimtaria: “Ndërtimi i një flugeri”.

Duke ndjekur hapat e paraqitur në librin e nxënësit, individualisht ndërtojnë flugerin me mjetet e punës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrika “Zbato njohuritë”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.14

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Puna, energjia dhe përhapja e dritës (shpjegon me shembuj dhe demonstrime, punën, energjinë dhe përhapjen e dritës)</i>		Rezultati i të nxëniet të temës: <i>Shpjegon katër llojet themelore të reve dhe përshkruan mënyrën e krijimit të reshjeve në tokë dhe në atmosferë.</i>	
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës : II.4, II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 2.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Era, retë dhe reshjet në Tokë			
Fjalët kyçe: era, retë, reshjet, shiu, bora, breshëri			
Rezultati/et e të nxëniet të orës mësimore: Nxënësi/ja: • Diskuton rreth njohurive paraprake lidhur me motin. • Identifikon mënyrat e formimit të reshjeve atmosferike. • Demonstron krijimin e shiut.			
Kriteret e suksesit: • Diskuton rreth motit dhe instrumenteve matëse të erës e shiut. • Identifikon mënyrat e formimit të reshjeve, si: shiu, bora, breshëri. • Demonstron krijimin e shiut me anë të ujit të valuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, gotë me grykë të gjerë, ujë i nxehtë, pjatë metalike, akull.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon orën duke biseduar me nxënësit rreth motit. <i>Për çfarë përdorej flugeri? Për çfarë përdorej anemometri? Çfarë është era?</i> Pasi merren përgjigje nga nxënësit, mësuesi/ja jep informacione shtesë rreth erës dhe krijimit të saj. Përmes projektorit shfaqen fotografitë e llojeve të reve, duke i klasifikuar ato sipas lartësisë ku ndodhen dhe formës së tyre. Retë e larta ndodhen në lartësi 7 - 13 km mbi sipërfaqen e Tokës. Retë e mesme ndodhen në lartësi 2 - 7 km mbi sipërfaqen e Tokës. Retë e ulëta ndodhen në lartësinë mbi 2 km mbi sipërfaqen e Tokës. Përmes projektorit, nxënësit do të shohin një video rreth krijimit të shiut, borës dhe breshrit. https://www.youtube.com/watch?v=zBnKgwnn7i4			

Mësuesi/ja nxit diskutimin rreth formimit të shiut, borës dhe breshrit, duke u parashtruar nxënësve pyetje: <i>Si krijohet shiu? Si krijohet bora? Po breshëri si formohet?</i> Realizohet veprimtaria: <i>Krijimi i shiut.</i> Duke ndjekur hapat e paraqitur në libër, me ndihmën e mësuesit/es nxënësit realizojnë krijimin e shiut.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësim i vazhdueshëm.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju” dhe “Zbato njohuritë”
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.15

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Vë në dukje lloje të burimeve të rrymës elektrike</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.2, 2.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Elektriciteti			
Fjalët kyçe: elektricitet, ngarkesë pozitive, ngarkesë negative, elektroskop, përcues, jopërcues			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: • Krahason llojet e elektriciteteve. • Dallon lëndët përcuese dhe ato jopërcuese. • Demonstron veçoritë e elektrizimit.			
Kriteret e suksesit: • Krahason llojet e elektriciteteve përmes shembujve konkretë. • Përmend së paku dy lëndë përcuese dhe dy jopërcuese. • Demonstron veçoritë e elektrizimit me dy trupa të ndryshëm.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, trup plastik, trup metalik, copa të vogla letre dhe polisteroli, një copë e leshtë			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë ndodh kur fërkohen dy trupa?

- E keni vënë re se dëgjojmë kërcitje të vogla gjatë zhveshjes së bluzave nga sintetika?

Pse ndodh kjo?

Për këto raste, nxënësit nxiten të përgjigjen nga përvoja e tyre.

Mësuesi/ja plotëson nxënësit në përgjigjet e tyre, duke iu sqaruar se: *Një trup mund të ngarkohet me elektricitet, pra të elektrizohet, nëse fërkohet me një trup tjetër.*

Nxënësit hapin librat në f. 82.

Lexohen dy shembujt nga libri dhe po ata konkretizohen në klasë.

Mësuesi/ja ka sjellë mjetet e nevojshme për të konkretizuar shembujt: *tullumbaceje e fryrë fërkohet fillimisht me flokun, ku shihet tërheqja e trupave, pra shohim elektricitetin e llojeve të ndryshme. Pastaj tullumbacet e fryra i fërkojmë me të njëjtën copë leshi, i varim në një fije dhe i lëmë të lira, vërejmë se tullumbacet shtyjnë njëra-tjetrën, por tërheqin copën e leshtë, pra kemi elektricitetin e llojit të njëjtë.*

Nxënësit udhëzohen të lexojnë paragrafin “Nga se shkaktohet elektriciteti”.

Mësuesi/ja i pyet nxënësit për informacionet e reja që kanë mësuar.

Nxënësit japin përgjigjet e tyre, të cilat plotësohen nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja paraqet video përmes projektorit, në të cilat nxënësit do të shohin *ngarkesat elektrike pozitive dhe ngarkesat elektrike negative.*

<https://youtu.be/zHJkJGBdvwE>

Zhvillohet veprimtaria “*Veçoritë e elektrizimit*”, ku nxënësit të organizuar në dyshe do të zhvillojnë veprimtarinë duke ndjekur hapat e dhënë në libër dhe do të shohin cilësitë e dy trupave përçues.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

1. Lexo, mendo dhe përgjigju.

2. Zbato njohuritë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.16

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Vë në dukje lloje të burimeve të rrymës elektrike.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.6, II.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rryma elektrike dhe burimet e saj			
Fjalët kyçe: energji elektrike, rryma elektrike e vazhduar/alternative, bateri			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
- Diskuton rreth njohurive paraprake. - Krahason përçuesit elektrikë dhe jopërçuesit.			
Kriteret e suksesit:			
- Diskuton për elektricitetin. - Krahason përçuesit elektrikë dhe jopërçuesit elektrikë nga përmbajtja e lëndës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
<i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja bën përsëritje nga njësia e kaluar për elektricitetin, që të arrijë qëllimin e orës.			
<i>Grimcat e ngarkuara me elektricitet, pra ngarkesat elektrike, që lëvizin nga një vend në një tjetër, zotërojnë energji.</i>			
<i>Energjia e lëvizjes në mënyrë të rregullt të tyre është ajo që e quajmë energji elektrike.</i>			
Nxënësit udhëzohen që t'i hapin librat në f. 84.			
Teksti lexohet me paragrafë nga nxënësit që përcaktohen nga mësuesi/ja. Njëri lexon, të tjerët dëgjojnë.			
Pas leximit të paragrafit të parë, hapet bazuar në pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja.			
<i>Cilët janë përçuesit më të mirë të elektricitetit?</i>			
<i>Çfarë lëndësh janë jopërçuesit e elektricitetit?</i>			
Lexohet paragrafi i dytë nga një nxënës tjetër. Mësuesi/ja parashtron pyetjet:			
<i>Si e përdorim energjinë elektrike në shtëpitë tona?</i>			
<i>Si përftohet energjia elektrike?</i>			
Lexohet edhe paragrafi i tretë nga një nxënës. Mësuesi/ja parashtron pyetjen:			
<i>Nga se shkaktohet rryma elektrike?</i>			

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësim i vazhduar bazuar në dhënien e përgjigjeve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika “Zbato njohuritë”; Fletore pune
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.17

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron qarkun e përbërë elektrik me dy-tre shpenzues të lidhur sipas dy mënyrave të mundshme.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.1, 1.5,			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qarku elektrik			
Fjalët kyçe: qark, pol pozitiv/negativ, konsumatorët, çelës, lidhje seri/paralel			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
• Rikujton njohuritë për qarkun elektrik. • Analizon lidhjen e konsumatorëve në një qark elektrik.			
Kriteret e suksesit:			
• Rikujton elementet e një qarku të thjeshtë elektrik. • Analizon lidhjen në seri dhe në paralel të konsumatorëve në një qark elektrik.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, limon, tel i fortë bakri, gozhdë, llambë e vogël, tela të hollë përçues			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
<i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja nxit nxënësit të rikujtojnë njohuritë paraprake me pyetje. Çfarë do të thotë “qark elektrik”?			
Nxënësit lihen të lirë të shprehin mendimet e tyre. Mësuesi/ja plotëson mendimet e nxënësve për qarkun elektrik. <i>Lëvizja e elektroneve, pra, rryma elektrike nëpër përcjellës, ekziston vetëm nëse kemi një qark elektrik. Kur kemi rrymë në një qark, qarku quhet “i mbyllur”.</i>			

Kërkon nga nxënësit që të hapin librin në f. 86-87 dhe të lexojnë tekstin “Qarkun elektrik”.

Pasi të kenë lexuar, diskutohet në klasë rreth njohurive të reja për qarkun elektrik, duke i nxitur nxënësit me pyetje.

Mësuesi/ja demonstroi para nxënësve veprimtarinë “Bateri në shtëpi”, duke ndjekur hapat e paraqitur në libër.

Në limon të shtypur paraprakisht, ngulet një tel bakri dhe gozhda me një largësi prej 2 cm. Me anë të telave të hollë, lidhim gozhdën dhe telin me një llambë të vogël.



Përmes projektorit, nxënësit do të shohin dhe një video ku ndërtohet qarku elektrik.

<https://www.youtube.com/watch?v=GrtfCmVwCzQ>

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërtimi i një qarku elektrik.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.18

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron qarkun elektrik të përbërë me dy-tre shpenzues të lidhur sipas dy mënyrave të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.5, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qarku elektrik (Punë praktike)			
Fjalët kyçe: qark i thjeshtë, kripë gjelle, ngjyrosës			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
Identifikon mjetet ndërtuese të qarkut elektrik.			

• <i>Shpjegon përdorimin e qarkut elektrik.</i> • <i>Ndërton qarkun elektrik.</i>
Kriteret e suksesit: • <i>Identifikon të gjitha mjetet ndërtuese të qarkut elektrik.</i> • <i>Shpjegon saktësisht përdorimin e qarkut elektrik në jetën e përditshme.</i> • <i>Ndërton një qark elektrik të thjeshtë.</i>
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, tela përcjellës, bateri llamba të vogla, kripë...
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja e fillon orën duke bërë përsëritje nga njësia e kaluar për qarkun elektrik, pjesët përbërëse të tij. Nxënësit njoftohen paraprakisht nga mësuesi/ja për punën që do të bëjnë. Ata udhëzohen të hapin librin në f. 92. Nxënësit janë të ndarë në 3 grupe, secili grup do të punojë qarkun që iu është caktuar, ata kanë sjellë në klasë mjetet e nevojshme. Nxënësit fillojnë punën bazuar në hapat që do të ndjekin nga libri. Mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht nxënësit, i udhëzon dhe i ndihmon sipas nevojës. Grupet e nxënësve prezantojnë punën e tyre me radhë.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerëson punën e nxënësve dhe prezantimin e tyre.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Fletore pune
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.19

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron reflektimin e dritës në pasqyrë të rrafshët dhe shpjegon karakteristikat e shëmbël-limit në to.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : II.4, II.6, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drita, burimet dhe karakteristikat e tjera			
Fjalët kyçe: drita, rrezatim drite, burime të drejtpërdrejta/të tërthorta, burime natyrore/artificiale			

Rezultati/et e të nxënës të orës mësimore.

Nxënësi/ja:

- Tregon veçoritë e dritës.
- Dallon burimet e dritës.
- Demonstron përhapjen e dritës.

Kriteret e suksesit:

- Tregon së paku tri veçori të dritës.
- Dallon burimet natyrore dhe artificiale të dritës.
- Demonstron përhapjen e dritës me anë të një elektriku dore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: karton, plastelinë, hapëse vrimash, elektrik dore

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja e fillon orën me pyetjen: **Çfarë është drita?**

Përgjigjet e nxënësve i shkruan në tabelë duke formuar një kllaster.



Udhëzon nxënësit t'i hapin librat dhe të lexojnë në heshtje tekstin në f. 90-91.

Pas leximit, hapet diskutimi në klasë, mësuesi/ja nxit nxënësit me pyetje, si:

- Cilat janë burimet e dritës?
- Si grupohen burimet e dritës?
- Çfarë është rrezja e dritës?
- Si përhapet drita?
- Me çfarë shpejtësie përhapet ajo?

Realizohet veprimtaria "Përhapja e dritës". Nxënësit, të udhëzuar nga ora e kaluar, kanë marrë me vete mjetet e punës. Tri copa kartoni me madhësi të njëjtë, plastelinë, hapëse vrimash dhe elektrik dore.

Nga këtu do të shohin se **drita përhapet në vijë të drejtë**.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.20

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron thyerjen e dritës gjatë kalimit nëpër dy mjedise me dendësi të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : II.1, II.8, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 2.1, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pasqyrimi dhe përthyerja e dritës			
Fjalët kyçe: i tejdukshëm, i patejdukshëm, mjete optike, thjerra përmbledhëse/shërhapëse, qelq zmadhues, mikroskop, teleskop			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore. Nxënësi/ja: - Dallon trupat e tejdukshëm dhe të patejdukshëm. - Liston të dhënat që di për pasqyrimin dhe përthyerjen e dritës. - Demonstron përthyerjen e dritës.			
Kriteret e suksesit: - Dallon së paku tre trupa te tejdukshëm dhe të patejdukshëm. - Liston së paku tre të dhënat që di për pasqyrimin dhe përthyerjen e dritës. - Demonstron përthyerjen e dritës përmes gotës së qelqit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri, laps, letër, ujë, gotë qelqi			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të afrohen te dritaret dhe të tregojnë çfarë po shohin përmes saj. Pastaj kërkon të drejtohen kah muri dhe pyet nxënësit: Po tani, a mund të shihni përtej? Pas këtyre veprimeve, mësuesi/ja parashtron pyetjet: - A kalon drita përmes çdo lënde? - Si quhet lënda që e lejon kalimin e dritës? - Si quhet lënda që nuk e lejon dritën të depërtojë?			
Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke u bazuar në atë që vështruan më herët. Mësuesi/ja paraqet njësinë e re mësimore: “Pasqyrimi dhe përthyerja e dritës” Nxënësve të organizuar në dyshe u shpërndahen fletët në të cilat është paraqitur tabela:			
Di	Dua të di	Mësova	

Në shtyllën e parë “Di” do të shkruajnë informacionet që dinë për pasqyrimin dhe përthyerjen e dritës.

Në shtyllën e dytë “Dua të di” do të shkruajnë pyetje rreth asaj se çfarë duan të dinë.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 92. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje.

Pasi të kenë lexuar informacionet e marra, i shkruajnë në shtyllën e tretë “Mësova”.

Mësuesi/ja demonstroi para nxënësve se si bëhet përthyerja e dritës. Pas gotës së mbushur me ujë, vendoset fleta në të cilën janë të vizatuara dy shigjeta me drejtime të njëjta. Kërkon nga nxënësit të shikojnë shigjetën e poshtme përmes gotës me ujë. Pyet nxënësit:

Çfarë vini re?

Çfarë ka ndryshuar?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrikat: “Lexo, mendo dhe përgjigju”. Zbato njohuritë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

3.21

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: <i>Proceset fizike</i>		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Demonstron thyerjen e dritës nëpër prizëm, krijimin e ngjyrave nga drita rënëse e bardhë dhe krijimin e mirazheve.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : I.3, II.3, II.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës : 1.5, 2.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drita dhe ngjyrat e saj			
Fjalët kyçe: dritë e bardhë, prizëm, ngjyrat e ylberit			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
<i>Tregon veçoritë e dritës së Diellit.</i> <i>Shpjegon formimin e ylberit.</i> <i>Plotëson pesëvargësh për dritën.</i>			
Kriteret e suksesit:			
<i>Tregon së paku tri veçori të dritës së Diellit.</i>			

- *Shpjegon formimin e ylberit nga zbërthimi i dritës së bardhë.*
- *Plotëson saktësisht pesëvargësh për dritën.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, karton i bardhë, lapsa me ngjyra

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja fillon orën duke iu parashtruar nxënësve pyetjet:

- *A e keni vë re që ylberi del në një ditë me shi, pasi ka dal Dielli? Pse?*
- *Po vetë ylberi, çfarë është?*
- *Nga se shkaktohet ai?*

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, përgjigjet e tyre plotësohen me informacione shtesë nga mësuesi/ja dhe shkruhen në tabelë.

Nxënësit udhëzohen që të hapin librin në f. 94 dhe të lexojnë tekstin për 10 min. në mënyrë individuale.

Ndërkohë, mësuesi/ja shkruan në tabelë disa pyetje rreth njësisë.

- *Nga çfarë përbëhet drita?*
- *Si i quajmë këto ngjyra?*
- *Kush e zbuloi që drita përbëhet nga ngjyra të ndryshme?*
- *Si shkaktohet ylberi?*

Pas leximit, mësuesi/ja hap diskutimin rreth pyetjeve. Nxënësit japin përgjigjet e tyre, mësuesi/ja plotëson me komente dhe shpjegime shtesë për secilën pyetje.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë një pesëvargësh, i cili plotësohet së bashku me nxënësit.

Drita

Nxënësit udhëzohen që duke ndjekur hapat e veprimtarisë në libër, të punojnë *diskun e ngjyrave*.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrikat: “Lexo, mendo dhe përgjigju” dhe “Zbato njohuritë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.1

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxënësve të temës: <i>Përshkruan gjithësinë dhe sistemin diellor, yjet, planetët , asteroidet, kometat, satelitët dhe hënën si trup qiellor e satelit natyror i tokës</i>	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës: II.2, III.2,III.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.3			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sistemi ynë diellor			
Fjalët kyçe: univers, galaktike, sistem diellor, orbitë, lëvizje, gravitet			
Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore:			
Nxënësi/ja: - përshkruan gjithësinë; - shpjegon sistemin diellor.			
Kriteret e suksesit: - Përshkruan gjithësinë bazuar në pyetjet e parashtruara. - Shpjegon sistemin diellor përmes ilustrimit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>libri i nxënësit, burime nga interneti, fletë A4, kub i improvizaur</i>			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: <i>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm</i>			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja parashtron për nxënësit pyetjet: <i>-Çfarë është gjithësia?</i> <i>-Çfarë vëreni natën?</i> Pasi merr përgjigje nga nxënësit, paraqet përmes projektorit një video, ku nxënësit do të shohin sistemin diellor. <i>https://www.youtube.com/hashtag/education</i> Mësuesi/ja paraqet njësine e re “Sistemi ynë diellor”, nxënësit hapin librin f. 26 dhe udhëzohen të lexojnë njësine në mënyrë individuale, në heshtje. Gjatë leximit ata do të identifikojnë me “+” gjërat e reja që i kanë mësuar, me “-” gjërat që nuk i kuptojnë dhe me “?” për ato gjëra që duan të dinë më shumë. Pas përfundimit të leximit, mësuesi/ja parashtron pyetje: <i>- Cilat janë gjërat e reja që mësuat?</i> <i>- Cilën pjesë nuk e kuptuat?</i> <i>- Çfarë doni të dini më shumë?</i>			

Diskutohet rreth njohurive paraprake, atyre të mësuara dhe atyre që nxënësit dëshirojnë të dinë. Mësuesi/ja nxit me pyetje rreth këtyre informacioneve.

Udhëzohen nxënësit që në fletë A4 të vizatojnë planetët sipas hapave në libër.

Gjatë gjithë kësaj kohe, mësuesja vëzhgon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Mësuesi/ja paraqet një kub para nxënësve, në faqet e tij shkruhen pyetjet e paraqitura në libër te pjesa “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

Nxënësit ndahen në dyshe, njëri nga nxënësit e hedh kubin dhe lexon pyetjen, tjetri përgjigjet në pyetjen e qëlluar. Varësisht nga përgjigjet e marra, ato mund të plotësohen nga nxënësit e tjerë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtari: Ndryshimi i madhësisë së planetëve të brendshëm nga ata të jashtëm.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore


4.2

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxënësve të temës: <i>Përshkruan Diellin si burim jete, pjerrtësinë e rrezeve të diellit dhe krijimin e zonave natyrore (brezat klimatik).</i>	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3, I.7, II.8, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dielli, burim i jetës			
Fjalët kyçe: Diell, rrezatim diellor, breza klimatikë			
Rezultati/et e të nxënësve të orës mësimore:			
Nxënësi/ja:			
- tregon njohuritë që ka për Diellin; - përgjigjet në pyetjet e parashtruara për veçoritë e Diellit; - analizon ndikimin e Diellit në Tokë.			
Kriteret e suksesit:			
- Jep së paku tri mendime rreth Diellit dhe veçorive të tij. - Përgjigjet saktë në të gjitha pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja për veçoritë e Diellit. - Analizon ndikimin e diellit si burim kryesor i jetës.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, burime nga interneti, Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja iu rikujton nxënësve njësinë e kaluar përmes klasterit të paraqitur në tabelë.



Klasteri plotësohet bashkërisht me nxënësit.

Mësuesi/ja paraqet njësinë mësimore “Dielli, burimi i jetës”.

Prezantohet para nxënësve një video, ku shihet rëndësia e rrezatimit diellor.

<https://youtu.be/v1TMa9Sëgk8>

Gjatë prezantimit të videos, mësuesi/ja jep sqarime rreth asaj që paraqitet.

Nxënësit mbajnë shënime në fletoret e tyre duke shikuar videon.

Udhëzohen nxënësit të hapin librin f. 98, lexohet nga nxënësit teksti në heshtje.

Udhëzohen nxënësit të vendosin lapsat në mes, mësuesja tërheq një laps. Nxënësit që i përket lapsi, do të përgjigjet në pyetjet që do të parashtrihen nga mësuesi/ja, që merren nga rubrika “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

Në mënyrë individuale plotësojnë pjesën, zbato njohuritë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtari: Hulumtoni ndikimin e diellit në jetën e bimëve (udhëzimi në tekst)

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.3

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxënित të temës: Përshkruan formën e tokës me dëshmi, duke e krahasuar me globin.	
Rezultatet e të nxënित për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.7,II.8, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore:** Toka jonë**Fjalët kyçe:** Toka, planet, formë sferike, pole, ekuator, forcë tërheqëse**Rezultati/et e të nxënës të orës mësimore:****Nxënësi/ja:**

- shkruan njohuritë që ka për planetët;
- tregon ato që di për planetin Tokë;
- nxjerr konkluzione për njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit:

- Shkruaj së paku tri njohuri që ke për planetët.
- Trego së paku dy gjëra që di për Tokën.
- Nxjerr konkluzione për faktet dhe opinionet për Tokën.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit,**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:***Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm***PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Mësuesi/ja paraqitet paraqet një fotografi para nxënësve, ku janë planetët dhe u drejton pyetje nxënësve:

- Cilët planetë po shihni?
- Po planeti ynë si quhet?
- Çfarë forme ka toka?



Marrim përgjigje nga nxënësit. Mësuesi/ja paraqet njësinë mësimore “Toka jonë”.

Mësuesja shpërndan fletë pune të përgatitur më parë, udhëzohen nxënësit të shkruajnë ato çka dinë për tokën, në rubrikën “Di”.

Di	Dua të di	Mësova

Pastaj pyet nxënësit se çfarë duan të dinë për Tokën, pyetjet e tyre i shkruajnë në rubrikën “dua të di”.

Udhëzohen nxënësit të hapin librin në f. 100 dhe të lexojnë njësine mësimore.

Pasi të kenë lexuar bashkërisht me mësuesin/en, plotësojnë rubrikën “mësova”.

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë rubrikën “Lexo, mendo dhe përgjigju”.

Nxënësit, të ndarë në grupe, plotësojnë tabelën “Zbato njohuritë” të paraqitur në libër. Fakt apo opinion? (Ku do të vendosin shenjen “+”).

Diskutojnë rreth asaj që kanë plotësuar në tabelë dhe nxirren konkluzione për token.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fletore pune

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.4

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: <u>V</u>
Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon rrotullimet e Tokës rreth Diellit dhe rreth boshtit të saj, si dhe rrjedhojat e këtyre lëvizjeve.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.6, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Pasojat e rrotullimit të Tokës			
Fjalët kyçe: Tokë, Diell, bosht, orbitë, rrotullim, ditë, natë, stinë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
- <i>Shpjegon pozicionin e Diellit dhe Tokës.</i> - <i>Tregon dy rrotullimet që bën Toka njëkohësisht.</i> - <i>Përshkruan me fjalë ndërrimin ditë-natë dhe të stinëve të vitit.</i>			
Kriteret e suksesit:			
- <i>Shpjegon pozicionin e Diellit gjatë ditës.</i> - <i>Tregon dy rrotullimet që bën Toka njëkohësisht.</i> - <i>Përshkruan me fjalë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.</i>			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: argjilë ose plastelinë, elektrik dore, letër me ngjitës, laps, shkop i hollë			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja, së bashku me nxënësit, dalin në ambientin e jashtëm dhe shohin pozicionin e Diellit në atë çast.

Pasi kanë parë pozicionin e Diellit, mësuesi/ja parashtron pyetje për diskutim:

Gjatë ditës, dielli nuk e ka pozitën e njëjtë, pse mendoni se ndodh kjo?

Jepen përgjigje nga nxënësit, duke u plotësuar me informata shtesë nga mësuesja.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë: *“Pasojat e rrotullimit të Tokës”*.

Iu shpjegohet nxënësve se Toka rrotullohet rreth vetes për 24 orë, nga Perëndimi në Lindje, pra në drejtim të kundërt me akrepat e orës.

Nxënësit udhëzohen të hapin librin në f. 102, lexohet paragrafi i parë nga nxënësi dhe pasi ta ketë lexuar, mësuesi/ja parashtron pyetjen: *Si bëhet ndërrimi i ditës dhe natës?*

Mësuesi/ja hap diskutimin. Përgatisin mjetet e punës për veprimtarinë, për të cilën janë përgatitur paraprakisht. Nxënësit udhëzohen të ndjekin hapat e dhënë në libër, veprimtaria kryhet me ndihmën e mësueses. Nxënësit do të vendosin dritën e elektrikut në glob, ku në të është vendosur një etiketë me emrin e Kosovës. Rrotullohet globi dhe kur ndriçohet, nxënësit do të tregojnë në cilën pjesë është “dita” dhe në cilën është “nata”. Nxënësit japin përgjigjet duke arsyetuar mendimin.

Mësuesi/ja paraqet katër stinët e vitit përmes projektorit.

Parashtron pyetjet:

- *Çfarë po shihni?*

- *Dita dhe nata formohen duke u rrotulluar Toka rreth vetes, po si bëhet ndërrimi i stinëve të vitit?*

Nxënësit japin mendimet e tyre, gjithashtu mësuesi/ja jep informacione plotësuese rreth ndërrimit të stinëve.

Nxënësit përgatiten për veprimtarinë e radhës, për të cilën njoftohen paraprakisht.

Nxënësit udhëzohen të modelojnë një sferë me plastelinë, që të ketë formën e Tokës, përcaktojnë Polin e Veriut dhe atë të Jugut. Me anë të elektrikut, shohim si përhapet drita mbi sferë.

Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre si përhapet drita mbi sferë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.5

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Identifikon dhe demonstroi mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.6, II.7,			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Globi, harta të ndryshme			
Fjalët kyçe: glob, hartë, kontinente			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore.			
Nxënësi/ja:			
- Tregon çfarë paraqesin harta dhe globi. - Identifikon vendet e paraqitura në hartë dhe glob. - Shkruan dallimet dhe ngjashmëritë mes globit dhe hartës.			
Kriteret e suksesit:			
- Tregon çfarë paraqesin harta dhe globi duke u bazuar në material. - Identifikon vendet që njeh në hartë dhe glob. - Shkruan së paku dy dallime dhe dy ngjashmëri mes globit dhe hartës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: globi, harta, lapsi, fletore, tabela			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon orën duke rikujtuar njësinë paraprake dhe parashtron pyetjen:			
- <i>Për çfarë shërben globi?</i>			
Mësuesi/ja shkruan në tabelë përgjigjet e nxënësve.			
Mësuesi/ja paraqet para nxënësve globin dhe hartën.			
			

Nxënësit analizojnë pamjen e tyre Hapin librin në f. 104, lexojnë njësinë mësimore, njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë. Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kanë kuptuar nga leximi, pasta jep shpjegime për termat <i>meridianë</i> dhe <i>ekuator</i>. Lexohet paragrafi i dytë, diskutohet me nxënësit çfarë kanë kuptuar dhe shpjegohet përdorimi i hartave. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vështrojnë hartën dhe globin, dhe të dallojnë vendet që kanë interes, për të ditur pozitën e tyre. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndahen në dyshe për të realizuar veprimtarinë, duke ndjekur hapat e paraqitur në libër. Më pas, ata prezantojnë punën e tyre. Ndahen nxënësit në grupe. Secili grup do të ketë nga një pyetje, anëtarët e grupit do të japin mendime rreth pyetjes së parashtruar në pjesën “Lexo, mendo dhe përgjigju”. Nxënësit udhëzohen t’i shkruajnë përgjigjet e tyre në fletore. Njëri nga përfaqësuesit e grupit përmbledh përgjigjen në tërësi dhe bën prezantimin para nxënësve.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimi.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika: <i>Zbato njohuritë.</i>
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.6

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Shpjegon rrotullimet e Tokës rreth Diellit dhe rreth bushtit të saj, si dhe rrjedhojat e këtyre lëvizjeve</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Hëna, sateliti kryesor i Tokës			
Fjalët kyçe: hënë, rrotullim, eklips, baticë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon dukurinë e eklipsit; - dallon dukurinë e eklipsit të Hënës dhe të Diellit; - demonstron dukurinë e eklipsit të Hënës dhe të Diellit.			

Kriteret e suksesit: • <i>Shpjego dukurinë e eklipsit sipas pozitive të trupave.</i> • <i>Dallo dukurinë e eklipsit të Hënës dhe Diellit sipas lëvizjes të Hënës.</i> • <i>Demonstro dukurinë e eklipsit të Hënës dhe të Diellit duke imituar pozicionet e tyre.</i>
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, një elektrik dore
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja fillon orën duke iu parashtruar nxënësve pyetjet: <i>Cili është satelit natyror i Tokës? Çfarë lëvizjeje kryen Hëna? A mund të zhvillohet jeta në Hënë?</i> Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë dhe formohet një grafik organizues për Hënë. Nxënësit hapin librat në f. 106. Lexohet me paragrafë. Njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë dhe mësuesi/ja parashtron pyetje për këtë pjesë: <i>Cili është njeriu i parë që zbriti në Hënë? Çka quajmë eklips? Cilat eklipse e përfshijnë Tokën?</i> Lexohet paragrafi i dytë nga një nxënës tjetër dhe, pas përfundimit, mësuesi/ja parashtron pyetjet: <i>Kur ndodh eklipsi i Hënës? Kur ndodh eklipsi i plotë i Hënës dhe sa zgjat?</i> <i>Kur ndodh eklipsi i pjesshëm i Hënës?</i> Lexohet edhe paragrafi i tretë nga një nxënës tjetër dhe pas përfundimit dhe të këtij paragrafi, mësuesi/ja parashtron pyetje për nxënësit: <i>Kur ndodh eklipsi i Diellit? Kur ndodh eklipsi i plotë i Diellit? Sa zgjat eklipsi i plotë i Diellit?</i> Mësuesi/ja, së bashku me nxënësit, analizon fotot e eklipsit të Hënës dhe eklipsit të Diellit. Zhvillohet veprimtaria “Simulimi i eklipsit të Diellit dhe të Hënës”, lexohen hapat që duhen ndjekur, ftohen tre nxënës te tabela, mësuesi/ja paraprakisht ka sjellë një elektrik dore në klasë. Mësuesi/ja, përmes pyetjeve, nxit nxënësit për ta realizuar veprimtarinë: <i>Në cilin pozicion do të qëndroni për ta imituar eklipsin e Hënës?</i> <i>Cilit trup i zihet drita e Diellit, Tokës apo Hënës?</i> <i>Në cilin pozicion duhet të qëndroni për ta imituar eklipsin e Diellit?</i> <i>Cilit trup do t'i zihet drita e Diellit?</i>
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohet pjesëmarrja aktive në dhënien e përgjigjeve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika “Zbato njohuritë”
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.7

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Sistemet fizike	Rezultati i të nxënit të temës: <i>Dallon sferat e brendshme të Tokës dhe përshkruan koren e Tokës-litosferën, e cila përbëhet nga shkëmbinjtë dhe lloje të ndryshme të tokave, me forma të ndryshme relievore-relievi-rrethina, me veçoritë e saj: malet, fushat, luginat, grykat, kanionet, ujëvarat</i>		
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.6, III.1			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6, 2.2, 2.4			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Toka ndryshon			
Fjalët kyçe: sipërfaqe e tokës, shtresa, pllaka kontinentale, tërmete, vullkan, erozion			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikojnë shtresat e Tokës; - argumentojnë ndryshimet e Tokës; - analizojnë shkaqet e ndryshimeve në Tokë. Kriteret e suksesit: - Identifikojnë shtresat e Tokës si, korja mantela, bërthama. - Argumentojnë krijimin e kontinenteve. - Analizojnë shkaqet e ndryshimeve në një reliev të caktuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, foto vullkani, kanioni, letër A4, laps			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Mësuesi/ja fillon orën duke shkruar fjalët kyçe në tabelë: <i>sipërfaqe e tokës, shtresa, pllaka kontinentale, vullkan, erozion</i> Nxitën nxënësit me pyetje për të rikujtuar njohuritë e mëparshme. <i>Si është terreni i tokës në vendbanimin tuaj? Cilat janë shtresat e tokës? Keni menduar se si janë formuar kontinentet?</i> Marrin përgjigje nga nxënësit, mësuesi/ja njofton nxënësit se përmes njësisë së re mësimore do të mësojmë më shumë rreth Tokës. Nxënësit i hapin librat në f. 108, lexojnë njësinë mësimore në mënyrë individuale. Pas leximit, mësuesi/ja parashtron pyetjet për nxënësit: <i>Si quhet shtresa e sipërme e Tokës? Cila shtresë ndodhet poshtë kores? Po poshtë mantelit, çfarë ndodhet? Çfarë mendojnë shkencëtarët për bërthamën e Tokës? Si janë formuar kontinentet? Si janë formuar malet, luginat, grykat,...? Pse ndodhin tërmetet? Çfarë ndryshimesh mund të pësojë Toka nga faktorët e jashtëm, si: uji dhe ajri?</i> Hapet diskutimi në klasë, nxënësit japin përgjigjet rreth pyetjeve, mësuesi/ja plotëson me shpjegime shtesë përgjigjet e nxënësve.			



Përmes projektorit shfaqen fotografitë e kanionit, malit vullkanik, ose fotografitë e shtypura vendosen në tabelë. Përmes tyre, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të zhvillojnë veprimtarinë e paraqitur në libër, *ku duhet të analizojnë shkaqet që kanë sjellë ndryshime në një reliev të caktuar të tokës*. Nxënësve u shpërndahen fletat e bardha A4 në të cilat do të shkruajnë mendimet e tyre dhe pastaj rezultatet e tyre do t'i diskutojnë dhe krahasojnë me shokët e tyre, duke dale në një rezultat të përbashkët.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrika “Zbato njohuritë”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.8

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Sistemet fizike		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Përshkruan prezencën dhe rëndësinë e ujit në Tokë, lëvizjet e ujit të detit, formimin e ujërave nëntokësore-minerale e sipërfaqësore dhe qarkullimin e ujit në natyrë</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, I.3,II.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6, 2.1, 2.5			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lëvizja e ujit të deteve dhe oqeaneve			
Fjalët kyçe: valë, dallgë, rrymë detare ose oqeanike, baticë, zbaticë			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore:			
Nxënësi/ja: - identifikon faktorin e lëvizjes së ujit; - shpjegon formimin e baticave-zbaticave.			
Kriteret e suksesit: - Identifikon erën si faktor të lëvizjes së ujit. - Shpjegon shkaktuesit e formimit të baticave dhe zbaticave.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, hamer
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Mësuesi/ja bën një përshkrim me fjalë të detit. <i>Kush ka qenë pranë detit, ka parë që deti ndryshon vazhdimisht. Herë duket i qetë e here është me dallgë. Në një moment të ditës, deti afrohet e pas disa orësh shohim që largohet.</i> Pastaj pyet nxënësit: <i>Çfarë e shkakton gjithë këtë lëvizje të detit?</i> Mësuesi/ja njofton nxënësit që për këtë dhe shumë gjëra tjera, do të mësojmë sot me njësinë e re, duke shkruar titullin në tabelë: <i>Lëvizja e ujit të deteve dhe oqeanëve</i> Udhëzohen nxënësit të hapin librat në f. 110 dhe të punojnë në çifte, ndahet klasa në çiftin 1 dhe 2 (njëri nga nxënësit të ulur në bankë është 1 tjetri 2). Çifti 1 do të lexojë paragrafin: <i>Çfarë e shkakton këtë lëvizje</i>. Çifti 2 do të lexojë paragrafin: <i>Çfarë e shkakton baticën dhe zbaticën?</i> Pasi të kenë lexuar për 5 min., nxënësit që janë përcaktuar 1-shat dhe 2-shat bëhen bashkë. Udhëzohen të bëjnë përmbledhje të asaj që kanë lexuar dhe ta përshkruajnë në hamer, ta shoqërojnë me ndonjë ilustrim. Pastaj do ta prezantojnë dy-tre nxënës si përfaqësues të grupit para klasës. Nxënësit diskutojnë, plotësojnë njëri-tjetrin gjatë prezantimit. Në fund, mësuesi/ja lexon pyetjet nga rubrika: “Lexo, mendo dhe përgjigju”, merr përgjigje nga nxënësit
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësim i vazhdueshëm
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Rubrika: <i>Zbato njohuritë</i>
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.9

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Sistemet fizike		Rezultati i të nxënës të temës: Dallon dh shpjegon vetitë themelore të atmosferës dhe elementeve meteorologjike si: temperatura e ajrit, shtypja e ajrit, lëvizja e ajrit-era, lagështija e ajrit-reshjet, llojet e reve.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.6, III.1, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Atmosfera dhe elementet meteorologjike			
Fjalët kyçe: atmosferë, mot, klimë, temperaturë-shtypje-lëvizje- lagështirë e ajrit, re, meteorologji			

Rezultati/et e të nxënës të orës mësimore:**Nxënësi/ja:**

- përshkruan rëndësinë e atmosferës;
- dallon dukuritë meteorologjike;
- ndërton hartën sinoptike.

Kriteret e suksesit:


- Përshkruan rëndësinë e atmosferës për Tokën.
- Dallon dukuritë meteorologjike mot-klimë.
- Ndërton hartën sinoptike me simbole përkatëse.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, letër, laps me ngjyra, një model harte i Kosovës

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën *Atmosfera*



Pyet nxënësit: *Ju kujtohet nga klasat e mëparshme nga se përbëhet atmosfera dhe cilat janë shtresa e saj?* Përgjigjet e marra nga nxënësit shkruhen pranë fjalës *Atmosferë*, duke i plotësuar nga ana e mësuesit/es sipas nevojës.

Kërkohet nga nxënësit të hapet libri në f. 112, udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë në heshtje. Ndërkohë, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjet:

Pse ka rëndësi atmosfera për Tokën?

Cilat dukuri meteorologjike formohen në atmosferë?

Si quhet shkenca që studion motin?

Cili është dallimi mes fjalëve mot dhe klimë?

Cilat janë elementet e motit?

Cilat janë tiparet e erës?

Cilat janë disa mjete që ndihmojnë në parashikimin e motit?

Pse është i rëndësishëm parashikimi i motit?

Pasi nxënësit të kenë lexuar, japin përgjigje rreth pyetjeve të paraqitura, mësuesi/ja shkruan përgjigjet e tyre pranë pyetjeve përkatëse.

Zhvillohet veprimtaria e paraqitur në libër: *Skicimi i një modeli të hartës sinoptike*

Jepen sqarimet nga mësuesi/ja se si nxënësit duhet të plotësojnë hartën me simbole, sipas dëshirës, për të bërë një përshkrim se si do të jetë moti.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Rubrika: *Zbato njohuritë*

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

4.10

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrë	Lënda: Njeriu dhe natyra	Shkalla e kurrikulës: II	Klasa: V
Tema: Sistemet fizike		Rezultati i të nxënit të temës: <i>Përshkruan prezencën dhe rëndësinë e ujit në Tokë, lëvizjet e ujit të detit, formimin e ujërave nëntokësore-minerale e sipërfaqësore dhe qarkullimin e ujit në natyrë</i>	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.6, III.1, III.4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Uji dhe rëndësia e tij për jetën			
Fjalët kyçe: ujëra nëntokësore, ujëra mbitokësore, cikli i ujit			
Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore: Nxënësi/ja: - përshkruan rëndësinë e ujit; -përshkruan ciklin e ujit në natyrë; -tregon se ku gjendet uji.			
Kriteret e suksesit: - përshkruan rëndësinë e ujit; -përshkruan ciklin e ujit në natyrë; -tregon se ku gjendet uji.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, flet A4, lapsa me ngjyra			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Nxënësit janë të organizuar në grupe. Secilit grup mësuesja i jep një fletë A4, në të cilën janë të parashtruara pyetjet: <i>Pse Toka njihet ndryshe si “planeti i kaltër? Ku gjendet uji? Pse është rëndësishëm uji për jetën në tokë?</i> Bazuar në këto pyetje, nxënësit shkruajnë për ujin.			
Uji			
Punën e përbashkët e lexon përfaqësuesi i grupi. Kështu veprohet me secilin grup.			
Mësuesi/ja udhëzon nxënësit t'i hapin librat në f. 114. Leximi i njësisë do të bëhet në mënyrë individuale. Gjatë leximit, secili nxënës duhet të shënoj me “V#” informacionet që i ka ditur më parë, me “+” informacionet e reja që tashmë i ka marrë dhe “?” gjërat që i ka të paqarta. Lihen nxënësit brenda një kohe të caktuar t'i sqarojnë njëri-tjetrit informacionet e paqarta.			

Nëse ka ndonjë gjë që nuk është mundur të qartësohet brenda anëtarëve të grupit, pyetja i parashtrohet mësuesit/es për sqarim.

Mësuesi/ja jep sqarime për çështjet që i kanë ngritur grupet e nxënësve.

Paraqitet përmes projektorit videoja ku tregon procesin se si formohet shiu. <https://www.youtube.com/watch?v=s0bS-SBAgJI>

Pas shikimit, udhëzohen nxënësit të vizatojnë ciklin e ujit në natyrë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Veprimtaria: *Si formohet shiu?*

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Katalogimi në botim (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës – “Pjetër Bogdani”

37.016:502.12(072)(075.2)

Dedushaj, Florentina

Njeriu dhe natyra 5 : libër për mësuesin : për klasën e 5-të të
arsimit fillor / Florentina Dedushaj. - Prishtinë : Pegi, 2022. -

124 : ilustr. ; 20.7 x 28 cm.

Mësimdhënia -- Edukimi shoqëror

Tekste për mësuesit -- Tekste për shkolla fillore

ISBN 978-9951-786-60-7

Aleph [000103354]